



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 67, datë 04.11.2004

PËR MIRATIMIN E "OPINIONIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË  
MBI GJENDJEN E EKONOMISË GJATË TREMUJORIT TË TRETË  
TË VITIT 2004"

Në mbështetje të nenit 43, shkronja "ç" dhe të nenit 69, pika 5 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë opinionin e Bankës së Shqipërisë "**Mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2004**", bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Politikës Monetare me dërgimin e këtij materiali në: Kuvendin e Shqipërisë, Presidencë, Këshillin e Ministrave, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Ekonomisë.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për botimin e këtij vendimi.
4. Vendimi nr. 54, datë 09.07.2003 i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, shfuqizohet.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

Ylli Memisha

KRYETARI

Ardian Fullani

**BANKA E SHQIPËRISË**

**OPINION  
MBI GJENDJEN E EKONOMISË  
GJATË TREMUJORIT TË TRETË TË VITIT 2004**

**TETOR 2004**

## **Përmbajtja**

<b>I.</b>	<b>Fjala e Guvernatorit</b>	<b>4</b>
<b>II.</b>	<b>Aktiviteti ekonomik</b>	<b>6</b>
II.1	Ekonomia botërore gjatë tremujorit të tretë	6
II.1.1	Ecuria e kursit të këmbimit	7
II.1.2	Çmimet e naftës	7
II.2	Aktiviteti ekonomik në vend	8
II.2.1	Ecuria e prodhimit të brendshëm sipas degëve të ekonomisë	9
II.2.2	Sektori fiskal	11
II.2.3	Sektori i jashtëm	12
II.2.4	Tregu i punës	15
<b>III.</b>	<b>Ecuria e inflacionit dhe politika monetare</b>	<b>17</b>
III.1	Ecuria e grupeve përbërëse të shportës së çmimeve të konsumit	17
III.2	Ambienti makroekonomik dhe çmimet e konsumit	20
III.3	Politika monetare e Bankës së Shqipërisë	21
<b>IV.</b>	<b>Zhvillimet monetare dhe tregjet financiare</b>	<b>24</b>
IV.1	Oferta monetare dhe agregatët monetarë	24
IV.2	Kërkesa e ekonomisë për mjete monetare	26
IV.2.1	Pozicioni valutor i sistemit bankar	26
IV.2.2	Kërkesa e qeverisë për para	26
IV.2.3	Kredia për ekonominë	27
IV.3	Zhvillimet në tregjet financiare	29
IV.3.1	Ecuria e likuiditetit në treg	29
IV.3.2	Ecuria e normave të interesit	30
IV.3.3	Kursi i këmbimit	32

## I. FJALA E GUVERNATORIT

Pas një tremujori të parë disi "të fjetur", ekonomia shqiptare ka treguar shenja të gjallërimit gjatë muajve në vazhdim të vitit 2004. Rritja ekonomike është zhvilluar në kushtet e ruajtjes dhe të konsolidimit të mëtejshëm të stabilitetit makroekonomik. Ecuria e inflacionit, gjatë nëntë muajve të parë të vitit, ka qenë e kontrolluar dhe brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë, duke krijuar hapësirat e nevojshme për një akomodim të mëtejshëm të politikës monetare të ndjekur prej Bankës së Shqipërisë. Kjo politikë është favorizuar edhe nga zhvillimet në treguesit monetarë ku spikat kthimi i parasë në sistem, qëndrueshmëria e likuiditetit, niveli i normave të interesit etj.. Nga ana tjetër, edhe treguesit fiskalë kanë ecur përgjithësisht brenda parashikimeve programore. Të ardhurat, shpenzimet dhe deficitit buxhetor kanë ndjekur linjën e programuar në fillim të vitit, ndërkohë që bilanci i pagesave ka qenë i qëndrueshëm dhe papunësia ka shënuar një rënie të lehtë.

Nga të dhënat që disponojmë, në tremujorin e dytë, rigjallërimi ekonomik vërehet më së shumti në sektorin e industrisë, të shërbimeve dhe në veçanti në atë të ndërtimit, pas një tremujori të parë të ngadaltë të këtij të fundit. Vëllimi i shitjeve gjatë tremujorit të dytë shënoi një rritje prej 19.6 për qind në krahasim me tremujorin e parë të vitit dhe prej 4.4 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Ndërkohë edhe nga sektori bujqësor vijnë sinjale optimiste që mbështesin bindjen, se parashikimi fillestar për rritjen vjetore të këtij sektori do të jetë i mundshëm për t'u realizuar. Po ashtu, tregues të tërthortë flasin për një rritje të aktivitetit ekonomik. Konsumi i energjisë elektrike nga konsumatorët jofamiljarë është rritur 15 për qind, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ndërsa kreditimi i ekonomisë ka njohur rritje të shpejtë gjatë vitit 2004.

Në bazë të ecurisë së deritanishme të sektorëve të ekonomisë mund të themi se në vazhdim të vitit 2004, parashikimi i rritjes ekonomike me 6 për qind është i arritshëm.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2004, Shqipëria ka realizuar një vëllim më të lartë transaksionesh korente në krahasim me gjysmën e parë të vitit 2003. Bilanci i llogarisë korente, për këtë gjashtëmujor, ishte 208 milionë dollarë ose rreth -5.4 për qind e PBB-së, duke mbetur pothuaj në po ato nivele me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Llogaria kapitale dhe financiare ka regjistruar hyrje kapitalesh neto në masën 266.5 milionë dollarë, duke e mbyllur gjashtëmujorin e parë të vitit me një fluks hyrës kapitali, ndjeshëm më të lartë se ai i të njëjtës periudhë së vitit të kaluar. Hyrja e valutës nëpërmjet transaksioneve korente dhe kapitale ka mundur rritjen e mjeteve të rezervës valutore bruto me 132 milionë dollarë.

Gjatë tremujorit të tretë presionet inflacioniste kanë qenë të ulta. Norma e inflacionit ka shënuar një ulje graduale, duke arritur në kufirin e poshtëm të intervalit objektiv të Bankës së Shqipërisë, 2 – 4 për qind, në fund të tremujorit të tretë. Edhe inflacioni mesatar vjetor ka qenë në rënie, duke arritur vlerën 3.1 për qind në muajin shtator. Ecuria e çmimeve të konsumit gjatë kësaj periudhe është kushtëzuar ndjeshëm nga rritja e prodhimit bujqësor vendas. Kjo ka bërë që kërkesa e rritur e muajve të verës të plotësohet me prodhimin vendas, i cili ka përgjithësisht çmime më të ulta se importi. Si rezultat, në ndryshim nga vitet e kaluara, kontributi i grupit 'Ushqim dhe pije joalkolike' në inflacionin total ka qenë negativ gjatë tremujorit të tretë. Ndikimi i rritjes së çmimit të naftës në tregjet botërore ka qenë relativisht i dobët në nivelin e inflacionit, si pasojë e peshës së vogël që ka ky artikull në shportën e çmimeve të konsumit dhe e mbiçmimit të lekut. Kushtet e përgjithshme makroekonomike: situata monetare, kërkesa e ekonomisë dhe situata fiskale kanë qenë nën kontroll, duke favorizuar ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Situata e likuiditetit ka qenë e qëndrueshme, normat e interesit, megjithë rënien e tyre, kanë vijuar të favorizojnë rritjen e depozitave në lekë dhe kthimin e parasë në sistemin bankar. Nga ana tjetër, rritja e moderuar e

ofertës monetare, ka plotësuar më së miri ritjen e kërkesës për para, karakteristikë sezonale për këtë periudhë.

Ashtu si edhe gjatë pjesës tjetër të vitit, politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka patur një kah të qartë lehtësues gjatë tremujorit të tretë. Niveli i moderuar i inflacionit dhe parashikimet optimiste për të, kanë sugjeruar uljen e mëtejshme të normës bazë të interesit. Në përgjigje të këtyre zhvillimeve, Banka e Shqipërisë uli normën bazë të interesit me 0.25 pikë përqindjeje në datën 28 korrik. Kjo ulje u bë në përputhje me politikën e deklaruar të Bankës së Shqipërisë për të ruajtur në ekonomi një nivel sa më të ulët normash interesi, i cili të jetë konsistent me objektivin e stabilitetit të çmimeve në një periudhë afatmesme. Pas kësaj uljeje, norma bazë e interesit zbriti në 5.5 për qind, niveli më i ulët i saj i aplikuar në Shqipëri.

Me gjithë uljet e normave nominale të interesit, niveli i ulët i inflacionit dhe stabilizimi i pritjeve inflacioniste të ekonomisë për të, kanë bërë që norma reale e interesit të jetë relativisht e lartë, duke ruajtur interesin për depozitimin e kursimeve në sistemin bankar. Për pasojë, struktura e likuiditetit ka vijuar të zhvendoset drejt mjeteve monetare afatgjata: depozita dhe bono thesari. Gjenerimi i depozitave në sistem rrit potencialin e ekonomisë për investime të brendshme, për kreditimin e ekonomisë dhe për financimin e deficitit buxhetor. Atraktiviteti i normave të interesit në lekë në krahasim me ato në valutë, në prani të një oferte të rritur të valutës gjatë muajve të verës, ka ushtruar presione për mbiçmimin e lekut. Tremujori i tretë shënoi një forcim të presioneve mbiçmuese ndaj kursit të këmbimit të lekut, veçanërisht nga hyrjet e mëdha të valutës gjatë kësaj periudhe. Në këto kushte, Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë në tregun valutor në kahun e blerjes së valutës, duke tërhequr ofertën e tepërt të saj dhe duke injektuar likuiditete në lekë.

Ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor ka sjellë injektimin në sasi të konsiderueshme të likuiditetit në ekonomi dhe, së bashku me flukset hyrëse të valutës, kanë ndikuar në ritjen më të shpejtë të ofertës monetare. Kjo rritje e ofertës ka plotësuar kërkesën për mjete monetare të ekonomisë. Kërkesa e qeverisë për mjete monetare ka vazhduar të mbulohej pothuajse tërësisht nga financimi i brendshëm me anë të bonove të thesarit dhe të obligacioneve qeveritare.

Ndërkohë, financimi i sektorit prodhues të ekonomisë ka shënuar rritje të shpejtë gjatë vitit 2004. Kreditimi i ekonomisë në raport me PPB-në ka shënuar rritje të vazhdueshme, duke reflektuar një angazhim më të madh të kursimeve në financimin e aktivitetit ekonomik. Në fund të muajit gusht 2004, teprica e kredisë arriti në 60.9 miliardë lekë (7.3 për qind e PBB-së). Gjithashtu, vihet re një rritje e numrit të bankave të angazhuara në tregun e huadhënies bankare. Ndërkohë, pas zhvillimeve të fundit në sistemin bankar, janë krijuar kushte për një gjallërim të ndjeshëm të kreditimit të ekonomisë nga sistemi bankar.

\*  
\*            \*

Zhvillimet e deritanishme në ekonominë e vendit kanë krijuar një pritshmëri relativisht pozitive për vitin 2004 dhe më tej. Objektivat kryesorë të zhvillimit të vendit për vitin 2004, duket se do të përmbushen në përputhje me parashikimet e programit afatmesëm të zhvillimit ekonomik të vendit. Në këto rrethana, duke vlerësuar veçanërisht zhvillimet e faktuara dhe të pritshme në inflacion, Banka e Shqipërisë vlerëson si të përshtatshme zbutjen e mëtejshme të politikës monetare, ç'ka do të përbëjë një mbështetje për nxitjen e aktivitetit ekonomik.

## II. AKTIVITETI EKONOMIK

### II.1 EKONOMIA BOTËRORE GJATË TREMUJORIT TË TRETË.

Pas një periudhe rritjeje të kënaqshme ekonomike në pjesën e dytë të vitit 2003 dhe muajt e parë të vitit 2004, gjatë muajve në vazhdim ekonomia botërore filloi të shfaqë shenja ngadalësimi dhe pasigurie. Rritja e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare është një faktor, i cili ka ndikuar në ngadalësimin e zhvillimit ekonomik. Nga ana tjetër, treguesit shpesh kontradiktorë të ekonomisë amerikane, veçanërisht ata të punësimit, kanë lëkundur kërkesën e brendshme, ndërkohë që ekonomia evropiane vazhdon të mbështetet kryesisht në kërkesën e huaj si burim i rritjes së saj ekonomike. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Azia vazhdojnë të japin mbështetjen kryesore në zhvillimin e ekonomisë botërore, ndërkohë që ecuri pozitive kanë pasur edhe vendet e Amerikës Latine dhe vendet që hynë së fundmi në Bashkimin Evropian.

Presionet inflacioniste kanë shënuar rritje në të gjitha ekonomitë duke zëvendësuar frikën e deflacionit që ishte e pranishme gjatë mesit të vitit 2003. Rritja e inflacionit është ndikuar nga rritja e çmimit të naftës, por, në shumë vende ka pasur rritje edhe të inflacionit bazë. Kjo rritje tregon se burimet e inflacionit kanë një bazë më të gjerë, duke përfshirë edhe faktorët e kërkesës.

**Tabela 1. Disa tregues kryesorë të ekonomive botërore (në përqindje).**

	PBB (tremujori i dytë)	Papunësia	IÇK	Deficiti buxhetor (% PBB-së)
Britani	3.6	4.7 (korrik)	+1.3 (gusht)	-2.9
Francë	2.8	9.9 (gusht)	+2.4 (gusht)	-3.8
Gjermani	2.0	10.7 (shtator)	+1.8 (shtator)	-3.7
Itali	1.2	8.5 (prill)	+2.1 (shtator)	-3.1
Japoni	4.2	4.8 (gusht)	-0.2 (gusht)	-7.1
USA	3.3*	5.4 (gusht)	+2.7 (gusht)	-4.7
Eurozonë	2.0	9.0 (gusht)	+2.2 (shtator)	-2.8
Kinë	9.2	-	+5.3 (gusht)	-

Burimi: "The economist", shtator 2004.

Aktiviteti ekonomik në Shtetet e Bashkuara është ngadalësuar disi gjatë muajve të fundit. Rritja e çmimit të naftës dhe gjendja reale e ekonomisë, e karakterizuar nga një normë punësimi më e ulët se ajo që pritej, kanë ndikuar në rënien e konsumit të individëve. Gjithashtu, deficiti i konsiderueshëm i llogarisë korente në ShBA përbën një shqetësim konstant për investitorët dhe politikëbërësit. Gjatë këtij tremujori FOMC<sup>1</sup> ka rritur 2 herë normën bazë të interesit, duke e çuar atë nga 1.25 për qind në 1.75 për qind. Këto vendime ishin të ndikuara nga rritja e presioneve inflacioniste dhe nga nevoja për të mbështetur dollarin amerikan në shkëmbimin e tij me monedhat e tjera. Gjithashtu, norma bazë e interesit në ShBA ka qenë në nivelin e saj më të ulët gjatë 40 viteve të fundit, një nivel i cili natyrisht nuk mund t'i rezistonte ritmeve të regjistruara të rritjes ekonomike.

Ecuria e aktivitetit ekonomik në Eurozonë ka qenë më e stabilizuar. Rritja vjetore në tremujorin e dytë, sipas të dhënave më të fundit, mendohet se do të jetë 0.5 për qind nga 0.6 për qind që ishte gjatë tremujorit të parë. Kërkesa e jashtme vazhdon të jetë baza e rritjes ekonomike ndërsa kërkesa e brendshme luan një rol modest. Eksporet neto kanë vazhduar të shënojnë vlera pozitive, pavarësisht se gjatë këtij tremujori, si pasojë e rritjes së çmimit të naftës, importet janë rritur ndjeshëm në krahasim me


<sup>1</sup> FOMC (Federal Open Markets Committee) është komiteti i Fed-it, i cili vendos për normat e interesit.

periudhat paraardhëse. Çmimet e naftës kanë ndikuar negativisht edhe në të ardhurat reale duke ulur konsumin privat. Për periudhën në vazhdim, pavarësisht zhvillimeve në tregun e naftës pritet që ecuria e ekonomisë së Eurozonës të jetë pozitive. Përmirësimet në tregun e punës do të çojnë në rritjen e të ardhurave të disponueshme, gjë e cila do të reflektohet në rritjen e konsumit privat duke shtuar kështu kërkesën e brendshme.

### II.1.1 Ecuria e kursit të këmbimit.

Gjatë këtij tremujori kursi i këmbimit midis dollarit dhe euros është luhatur në një interval të ngushtë. Çmimi i lartë i naftës, ecuria e normave afatshkurtra të interesit dhe pritjet mbi ecurinë e ekonomisë amerikane dhe të eurozonës, kanë qenë disa nga faktorët kryesorë që kanë ndikuar në trendin e kursit të këmbimit. Në fillim të muajit gusht, të dhënat që erdhën nga ekonomia amerikane për thellimin e deficitit buxhetor dhe të deficitit të llogarisë korente si dhe sinjalet jo shumë pozitive nga tregu i punës amerikan, ndikuan në vlerësimin e euros. Ndërkohë që njoftimi i rritjes së investimeve kapitale në Shtetet e Bashkuara për muajin korrik, e kombinuar kjo me një rritje në yield-in e bonove amerikane, mbështetën vlerësimin e dollarit gjatë gjysmës së dytë të muajit gusht. Në muajin shtator, euro është vlerësuar gradualisht ndaj dollarit amerikan. Të dhënat për një rritje të moderuar të inflacionit kontribuan në rënien e yield-it të bonove të thesarit amerikan, duke shtuar presionet ndaj dollarit. Ndërkohë që të dhënat mbi treguesit e tjerë të ekonomisë kanë qenë në të njëjtën linjë me pritjet, duke mos ndikuar në këtë mënyrë në ecurinë e kursit të këmbimit. Edhe vendimi i datës 21 shtator i FOMC-së për të rritur me 0.25 pikë përqindje normën bazë të interesit nuk e mbështeti vlerësimin e monedhës amerikane.

**Grafik 1. Ecuria e kursit të këmbimit gjatë tremujorit të tretë (usd/euro).**




### II.1.2 Çmimet e naftës

Në tregjet e naftës çmimet kanë pësuar rritje të konsiderueshme. Çmimi i naftës për barelë është rritur me rreth 44.4 për qind që prej fillimit të vitit. Faktorët që kanë nxitur rritjen e çmimeve kanë qenë si nga krahu i kërkesës ashtu edhe nga ofruesit e naftës. Zhvillimet në ekonominë globale, në mënyrë të veçantë rimëkëmbja e ekonomisë amerikane dhe bumi ekonomik në Kinë, kanë bërë që kërkesa për naftë të jetë më e larta e viteve të fundit. Nga ana tjetër, problemet në disa prej vendeve eksportuese të naftës kanë ndikuar në rritjen e çmimeve. Çështja e sigurisë në Gjirin Persik, sabotimet e vazhdueshme të puseve të naftës në Irak, gjendja e vështirë e kompanisë së naftës Yukos në Rusi dhe grevat në Nigeri, kanë ndikuar në rritjen e pasigurisë. Pavarësisht se OPEC-u ka zvogëluar sasinë rezervë dhe planifikon që të

risë ofertën me 400,000 barrele në ditë gjatë këtij viti dhe me 700,000 barrele në ditë gjatë vitit 2005, prodhimi nuk e plotëson tërësisht kërkesën, gjë që do të ndikojë në mbajtjen lart të çmimit edhe në periudhën në vazhdim. Në bazë të studimeve të bëra nga FMN<sup>2</sup>, çmimi i naftës në vitin 2005 do të jetë rreth 8 dollarë më i lartë se çmimi në vitin 2003. Një rritje e tillë e çmimit do ta ulte PBB-në botërore me rreth 0.5 për qind.

**Grafik 2. Çmimet e naftës për periudhën qershor '03-shtator '04 (usd për barrelë).**



## II.2 AKTIVITETI EKONOMIK NË VEND.

Ekonomia shqiptare ka treguar shenja të rritjes ekonomike, gjatë gjysmës së parë të vitit 2004. Pas një tremujori të parë të ngadaltë, të dhënat e tremujorit të dytë dhe të dhënat operative të tremujorit të tretë tregojnë se sektorë të ndryshëm të ekonomisë si industria dhe shërbimet kanë patur një rritje të dukshme në krahasim me vitin e shkuar. Gjithashtu, edhe sektori i ndërtimit ka patur një ecuri mjaft pozitive gjatë tremujorit të dytë, pas një tremujori të parë të ngadaltë. Kështu, vëllimi i shitjeve gjatë tremujorit të dytë shënoi një rritje prej 19.6 për qind në krahasim me tremujorin e parë të vitit dhe prej 4.4 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Në bazë të ecurisë së deritanishme të sektorëve të ekonomisë mund të themi se në vazhdim të vitit 2004, parashikimi i rritjes ekonomike me 6 për qind është i arritshëm. Zhvillimi i vullshëm i sektorit të ndërtimit, rritja e kënaqshme në degët e industrisë nxjerrëse dhe përpunuese, dhe parashikimet më optimiste për zhvillimin e sektorit të bujqësisë në krahasim me vitin e kaluar, mbështesin parashikimet për realizimin e objektivit. Të dhënat e sektorit të bujqësisë tregojnë se parashikimi fillestar për rritjen vjetore të këtij sektori është i realizueshëm. Gjithashtu, tregues të tërthortë flasin për një rritje të aktivitetit ekonomik. Konsumi i energjisë elektrike nga konsumatorët jofamiljarë është rritur 15 për qind gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit, në krahasim me të njëjtën periudhë të viti të kaluar, ndërsa kreditimi i ekonomisë ka njohur rritje të shpejtë gjatë vitit 2004. Po kështu, vëllimi i shërbimeve portuale për eksporte është rritur në masën 81 për qind gjatë tremujorit të dytë të vitit në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rritja e shpenzimeve buxhetore kapitale në sajë të përdorimit të të ardhurave të privatizimit të Bankës së Kursimeve, do të ndihmojë aktivitetin ekonomik gjatë tremujorit të fundit.

**Tabela 2. Rritja e parashikuar e ekonomisë për vitin 2004 (në përqindje).**

	2002	2003	2004
Rritja reale e PBB-së	4.7	6.0	6.0
- Industria	1.8	2.7	3.1
- Bujqësia	2.1	3.0	3.0

<sup>2</sup> IMF, World Economic Outlook, shtator 2004.



- Ndërtimi	8.7	11.3	10.6
- Transporti	9.7	10.8	10.1
- Shërbime	5.1	6.4	6.4

## II.2.1 Ecuria e prodhimit të brendshëm sipas degëve të ekonomisë

### Bujqësia

Prodhimi në degën e bujqësisë është parashikuar të rritet me 4 për qind<sup>3</sup> gjatë vitit 2004. Sektori i agroindustrialit pritet të ketë rritjen më të theksuar me 10 për qind, ndërkohë që dy sektorët e tjerë, bujqësia dhe peshkimi, parashikohet të rriten përkatësisht me 3 për qind dhe 4 për qind.

Vlerësimet më të fundit, të bëra nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, konfirmojnë parashikimin e fillimvitit për rritjen e prodhimit të përgjithshëm bujqësor. Sipas vërtetimit mbi prodhimin në sektorin e agroindustrialit të kryer nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, prodhimi agroindustrial është rritur me 9 për qind gjatë gjysmës së parë të vitit 2004 në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rritje vihet re në prodhimin e mishit, të produkteve të konservuara dhe të pijeve alkolike, ndërkohë që përpunimi i grurit ka shënuar rënie. Duke qenë se prodhimi në sektorin e agroindustrialit ka natyrë sezonale, me përqëndrim më të theksuar të prodhimit gjatë gjysmës së dytë të vitit, ecuria e këtij sektori parashikohet të jetë pozitive edhe gjatë pjesës së mbetur të tij.

**Tabela 3. Ecuria e prodhimit agroindustrial gjatë vitit 2004.**

	T2 `04/T1 `04 (në %)	T2 `04/T2 `03 (në %)	6M1 04`/6M1 `03 (në %)
Prodhimi agroindustrial	8.4	0.2	9.0
Mish dhe nënprodukte të tij	10.6	16.6	16.4
Produkte të konservuara	36.1	20.0	-5.7
Qumësht dhe nënprodukte të tij	40.6	7.0	6.8
Miell gruri dhe buke	-1.0	-6.1	1.0
Pije alkolike	38.4	45.0	34.8
Ujë dhe pije freskuese	-10.9	-14.4	12.1

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

Megjithëse mungojnë të dhëna përfundimtare për prodhimin bujqësor, ecuria e tij duket të jetë pozitive. Këtë konsideratë e mbështet edhe ecuria e çmimeve të produkteve bujqësore në tregun e brendshëm, niveli i çmimeve të cilave ka regjistruar rënie gjatë gjashtëmuorit të fundit. Duke qenë se niveli i importeve të produkteve bujqësore nuk ka shënuar rritje në krahasim me vitin e kaluar, rritja e ofertës në tregun e brendshëm ka ardhur si pasojë e rritjes së prodhimit të brendshëm. Kushtet e mira klimaterike të fillimvitit dhe rritja e sipërfaqeve të mbjella me sera kanë ndihmuar prodhimin vendas.

Importet e produkteve bujqësore (në lekë) gjatë gjashtëmuorit të vitit 2004 kanë qenë pothuajse të njëjta me ato të gjashtëmuorit të parë të vitit të kaluar. Brenda kësaj kategorie, importet e mishit dhe të vajrave vegjetale kanë shënuar rënie, ndërsa importet e drithërave dhe ato të zarzavateve janë rritur në krahasim me gjysmën e parë të vitit të kaluar.

Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit vazhdon të jetë e angazhuar me një sërë projektesh, të cilat synojnë përmirësimin e infrastrukturës në degën e bujqësisë.

<sup>3</sup> Sektori i bujqësisë këtu përfshin edhe agroindustrialin.


Përgjatë gjashtë muajve të parë të vitit është realizuar në masën 96 për qind projekti i dytë i rehabilitimit të ujitjes dhe kullimit si dhe vazhdojnë të zbatohen projektet e tjera si projekti i shërbimeve bujqësore, projekti i zhvillimit të peshkimit dhe programi i zhvillimit të zonave malore.

### Industria, ndërtimi, transporti

Ecuria e shitjeve të sektorëve të industrisë, të ndërtimit dhe të transportit<sup>4</sup> për tremujorin e dytë të vitit 2004, tregon se ata janë rritur me ritme të kënaqshme. Rritja është vënë re si në krahasim me tremujorin e parë, ashtu edhe në krahasim me tremujorin e dytë të vitit të kaluar. Aktiviteti industrial është mbështetur edhe nga rritja me 9 për qind e prodhimit të brendshëm të energjisë elektrike si dhe nga rritja me 15 për qind e përdorimit të energjisë elektrike nga ana e konsumatorëve jofamiljarë.

Në sektorin e industrisë, nëndega që mban peshën më të madhe, industria përpunuese, ka realizuar 28 për qind më shumë shitje gjatë tremujorit të dytë sesa gjatë tremujorit të parë të vitit në vazhdim. Sektori i ndërtimit, gjithashtu ka paraqitur një rritje të theksuar të shitjeve ndaj të dyja periudhave krahasuese: rritje me 52 për qind ndaj tremujorit të parë të vitit 2004 dhe me 17 për qind ndaj tremujorit të dytë të vitit 2003. Kjo ecuri tregon për zhvillime reale pozitive në këtë sektor, duke qenë se Indeksi i Kushtimit në Ndërtim tregon një rritje më të lehtë. Analiza e Indeksit të Kushtimit në Ndërtim gjatë tremujorit të dytë, tregon një rritje prej 3.1 për qind të shpenzimeve direkte për materiale ndërtimi si dhe një rritje prej 3.7 për qind në paga, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Gjithashtu, vihet re se fitimi i parashikuar në këtë sektor ka rifilluar të ketë tendenca pozitive duke u rritur me 3.2 për qind, ndërkohë që kostoja e ngritjes së kantierëve ka rënë me 5.6 për qind.

**Grafik 3. Ecuria e shitjeve të disa sektorëve të industrisë (në miliardë lekë).**



Burimi: INSTAT.

Në ndryshim nga sektorët e industrisë dhe të ndërtimit, shitjet në sektorin e transportit, kanë regjistruar një rënie prej 1.1 për qind në tremujorin e dytë të këtij viti, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në këtë rënie ka kontribuar mosrealizimi i plotë i investimeve në këtë sektor, si nga burimet buxhetore ashtu edhe nga ato të huaja. Këto investime janë realizuar përkatësisht në masën 82 për qind dhe 50 për qind të planit gjatë tremujorit të dytë. Ndërkohë, aktiviteti i ngarkim-shkarkimit tregon shenja pozitive. Vëllimi i punës eksportuese në porte është rritur në masën 81 për qind në tremujorin e dytë dhe 21 për qind në periudhën korrik-gusht, në krahasim me të njëjtat periudha të një viti më parë.

<sup>4</sup> Sektorët e industrisë, të ndërtimit dhe të transportit, në vitin 2002, përbënin përkatësisht 14.5, 9.5 dhe 9.0 për qind të PBB-së. Burimi: INSTAT, Produkti i Brendshëm Bruto 1996-2002, Shtator 2004.

**Tabela 4. Ndryshime në vëllimin e punës së ngarkim-shkarkimit (në përqindje).**

	Tremujori i II-2004/2003	Korrik – Gusht 2004/2003
Gjithsej	+9	+5
Hekurudha	+24	-38
Portet	+7	-7
- Import	+2	+8
- Eksport	+81	+21

Burimi: Ministria e Transportit.

## Shërbimet

Grupi 'Tregti, hotele, restorante' përfaqëson 19 për qind të PBB-së, ndërkohë që 'Shërbimet e tjera' kontribuojnë me 22.5 për qind në prodhimin e përgjithshëm të vendit. Të dy këta grupe kanë regjistruar rritje të shitjeve gjatë tremujorit të dytë të vitit 2004 ndaj të dyja periudhave të krahasimit. Rritja më e theksuar vërehet në grupin 'Shërbime të tjera', i cili ka realizuar rreth 24 për qind më tepër shitje në tremujorin e dytë të vitit 2004, në krahasim me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar. Grupi 'Tregti, hotele, restorante' nuk ka paraqitur ndonjë ndryshim të dukshëm nga e njëjta periudhë e vitit të kaluar, ndërkohë që është regjistruar një shtim i aktivitetit me rreth 21 për qind në krahasim me tremujorin e parë të këtij viti. Ecuria e sektorit të shërbimeve të kësaj natyre është e kënaqshme dhe duket se do të ndihmojë realizimin e objektivit të rritjes ekonomike për vitin 2004.

## II.2.2 Sektori fiskal

Politika fiskale ka qenë e kujdeshme gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2004, në drejtim të kontrollit të shpenzimeve dhe të deficitit buxhetor. Në buxhetin e shtetit janë derdhur 132.5 miliardë lekë ose 92 për qind të të ardhurave të planifikuara për këtë periudhë, ndërkohë që shpenzimet e realizuara nga ana e qeverisë kanë qenë 151.3 miliardë lekë ose rreth 91 për qind e planit. Si të ardhurat, ashtu edhe shpenzimet, në vlerë absolute, tregojnë rritje në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Treguesit fiskalë janë rritur gradualisht gjatë tremujorëve duke patur vlerat më të larta në tremujorin e tretë. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar të ardhurat janë rritur me 9.1 për qind ndërsa shpenzimet me 9.6 për qind. Të ardhurat buxhetore kanë ruajtur pothuajse të njëjtin nivel me atë të vitit të kaluar në raport me PBB-në (21.3 për qind nga 21.7 për qind), ndërkohë që shpenzimet kanë rënë nga 25.2 për qind në 24.3 për qind, duke bërë që deficitin buxhetor, deri në fund të muajit shtator, të shënojë 3.0 për qind të PBB-së. Kontrolli i shpenzimeve buxhetore dhe i deficitit buxhetor brenda niveleve të parashikuara, ka bërë që presionet inflacioniste nga ana e sektorit fiskal të mos jenë të ndjeshme.

**Tabela 5. Treguesit fiskalë për vitin 2004 (në miliardë lekë).**

Në miliardë lekë	T1-04	T2-04	T3-04	9M - 2004	PBB (%)	Plani (%)	2003 (%)
A. Totali i të ardhurave	41.4	44.6	46.5	132.5	21.3	91.9	109.8
1. Të ardhura tatimore	37.7	40.3	42.3	120.3	19.3	96.6	112.8
2. Të ardhura jotatimore	3.4	4.0	4.2	12.1	2.0	68.6	90.6
B.Totali i shpenzimeve	43.4	51.0	56.9	151.3	24.3	90.5	108.1
1. Shpenzime korente	38.9	44.8	46.7	130.3	20.9	98.9	108.8
2. Shpenzime kapitale	4.5	6.2	10.3	21.0	3.4	63.1	104.2
C. Deficiti buxhetor	-2.0	-6.4	-10.4	-18.9	3.0	81.7	97.9

Rritja ekonomike dhe rritja e bazës tatimore kanë ndikuar në rritjen e të ardhurave. Ndërsa shpenzimet korente vazhdojnë të realizohen sipas planit, shpenzimet kapitale

janë realizuar vetëm në masën 62.2 për qind. Deficiti buxhetor është financuar në masën 68 për qind prej burimeve të brendshme.

### **Të ardhurat buxhetore**

Të ardhurat e përgjithshme në buxhetin e shtetit për periudhën janar-shtator kanë qenë rreth 132.5 miliardë lekë. Këto të ardhura, edhe pse më të pakta nga ato të parashikuara në planin e fillimvitet, kanë qenë rreth 10 për qind më të larta se të ardhurat e së njëjtës periudhë për një vit më parë. Gjatë nëntë muajve të parë të vitit, të ardhurat tatimore nga tatimet dhe doganat kanë siguruar mesatarisht 91 për qind të të ardhurave të përgjithshme. Peshën më të madhe në këtë kategori e zënë të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar, i cili siguron rreth gjysmën e të ardhurave nga tatimet dhe doganat. Tatimi mbi vlerën e shtuar, deri në muajin gusht, ka siguruar 102 për qind të të ardhurave të planifikuara nga kjo kategori. Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin dhe akcizat kanë shënuar rritje veçanërisht në tremujorin e tretë.

### **Shpenzimet buxhetore**

Shpenzimet e përgjithshme gjatë periudhës janar-shtator 2004 kanë qenë rreth 131.5 miliardë lekë. Shpenzimet korente vazhdojnë të zënë peshën më të madhe të shpenzimeve gjithsej. Megjithatë, një zhvillim pozitiv i muajve të fundit është rritja e shpenzimeve kapitale, të cilat nga 9 për qind e shpenzimeve të përgjithshme në muajin janar, janë rritur gradualisht në rreth 20 për qind të tyre në muajin gusht. Më tepër se gjysma e shpenzimeve korente kanë mbuluar pagat dhe sigurimet sociale, ndërkohë që pagesat për interesat, dhe sidomos për ato të brendshme, kanë ardhur në rënie gjatë nëntëmuajorit të parë të vitit. Rënia në pagesat e interesit nga 24 për qind në 12 për qind të shpenzimeve të përgjithshme prej muajit janar deri në muajin gusht, shpjegohet me uljen e normave të interesit të bonove të thesarit, gjë që ka zvogëluar barrën e borxhit të brendshëm të qeverisë. Ndërkohë, shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 63 për qind të planit, fakt që shtron nevojën e një vëmendjeje më të madhe të qeverisë në këtë drejtim.

### **Deficiti buxhetor**

Deficiti buxhetor, deri në fund të muajit shtator, ishte 18.9 miliardë lekë. Pjesa më e madhe e deficitit (nga 50 deri në 90 për qind e tij) është financuar nëpërmjet burimeve të brendshme, sidomos gjatë tremujorëve të dytë dhe të tretë të vitit 2004. Deficiti buxhetor deri në fund të muajit shtator vlerësohet të ketë arritur në rreth 82 për qind të deficitit të planifikuar.

### **II.2.3 Sektori i jashtëm**

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2004, Shqipëria ka realizuar një vëllim më të lartë transaksionesh korente në krahasim me gjysmën e parë të vitit 2003. Bilanci i llogarisë korente për këtë gjashtëmuaj, ishte 208 milionë dollarë ose rreth -5.4 për qind e PBB-së. Ky raport është pothuajse i njëjtë me atë të një viti më parë - 5.3 për qind. Rritja nominale e deficitit korent me rreth 36 për qind nuk është reflektuar në rritjen e raportit të këtij treguesi ndaj PBB-së, për shkak të rritjes së PBB-së dhe të dobësimit të dollarit ndaj monedhës vendase. Ashtu si edhe në vitet e mëparshme, peshën më të madhe në transaksionet korente e kanë mbajtur transaksionet tregtare në mallra si edhe transfertat korente. Llogaria kapitale dhe financiare ka regjistruar një hyrje neto

prej 266.5 milionë dollarësh, duke e mbyllur gjashtëmujorin e parë të vitit me një fluks hyrës kapitali, ndjeshëm më të lartë se ai i të njëjtës periudhë për një vit më parë. Hyrjet e kapitalit janë kushtëzuar në masë të madhe nga të ardhurat nga privatizimi i Bankës së Kursimeve, të cilat kanë bërë që të rriten detyrimet e rezidentëve në formën e investimeve direkte të huaja në vend. Hyrja e valutës nëpërmjet transaksioneve korente dhe kapitale ka mundësuar rritjen e mjeteve të rezervës valutore bruto me 132 milionë dollarë.

**Tabela 6. Bilanci i pagesave për gjashtëmujorët e parë (në milionë dollarë).**

	Hyrje	Dalje	Bilanci- 6M1-04	Bilanci- 6M1-03
A.Llogaria korente	1,261.0	-1,469.3	-208.3	-152.9
A.1.Tregtia në mallra	289.8	-978.5	-688.7	-625.6
A.2.Tregtia në shërbime	434.8	-440.7	-5.9	-11.2
A.3.Të ardhurat	82.0	-13.6	68.4	81.2
A.4.Transfertat korente	454.5	-36.6	417.9	402.7
Llogaria kapitale dhe financiare			266.5	179.0
B.Llogaria kapitale			59.70	67.5
C.Llogaria financiare			206.8.0	111.5
D.Rritja në mjetet e rezervës			132.3	61.2

### Tregtia në mallra

Gjatë analizës së tregtisë në mallra dhe në përgjithësi të të gjitha shifrave të bilancit të pagesave, duhet të marrim parasysh ecurinë e kursit të këmbimit dhe konkretisht atë të lekut me dollarin amerikan. Zhvlerësimi i dollarit, sidomos gjatë periudhës dhjetor '02 - qershor '04 bën që rritja në vëllimin e transaksioneve të matura në dollarë korentë, të rezultojë më e lartë sesa rritja reale. Nëse nuk marrim në konsideratë efektin e vlerësimit të lekut ndaj dollarit amerikan gjatë periudhës së lartpërmendur<sup>5</sup>, rritja e eksporteve do të rezultonte 9 për qind nga 30 për qind që vlerësohet në dollarë korentë, ndërkohë që rritja e importeve nga 15 për qind kthehet në një rënie prej 3.5 për qind.

Peshën kryesore në importet totale vazhdojnë ta mbajnë mallrat ushqimorë (17 për qind), makineritë dhe pajisjet (17 për qind), tekstilet dhe artikujt tekstilë (11 për qind) etj.. Në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar janë rritur në shkallë modeste importet e produkteve vegjetale, ato të tekstileve, një pjesë e të cilave përdoren si lëndë e parë në industrinë e përpunimit aktiv, si edhe importet e metaleve bazë. Në përgjithësi, rritja relativisht më e lartë e importeve në mallrat që përdoren si lëndë e parë për përpunim të mëtejshëm në vend apo në makineritë që përdoren për prodhim, në krahasim me importet e mallrave të konsumit është një sinjal pozitiv për ecurinë e ekonomisë së vendit.

Eksportet, përveç rritjes nominale dhe reale, kanë regjistruar zhvillime pozitive në drejtim të diversifikimit të shportës së mallrave të eksportuar. Kështu, përveç rritjes së eksporteve të grupmallrave 'tekstile dhe artikuj tekstilë' dhe 'veshje koke dhe këmbë, çadra etj.', gjashtëmujori i parë ka regjistruar dhe rritje të eksporteve të produkteve minerale dhe metaleve bazë. Edhe tregtia me jashtë, ka reflektuar përmirësimin e ecurisë së ekonomisë gjatë tremujorit të dytë. Eksportet e tremujorit të dytë ishin 12 për qind më të larta sesa eksportet e tremujorit të parë, ndërsa importet rreth 16 për qind më të larta.

<sup>5</sup> Ky vlerësim bëhet duke llogaritur eksportet me kurs konstant – Dhjetor 2002.

Përsa iu përket çmimeve të importit, të cilat luajnë rol në përcaktimin e çmimit final në mallrat e konsumit (Indeksi i Çmimeve të Konsumit) dhe në lëndët e prodhimit (Indeksi i Çmimeve të Prodhimit), për pjesën më të madhe të grupmallrave, deri në fund të tremujorit të parë të vitit 2004, ndryshimet kanë qenë pothuajse të pandjeshme. Çmimet e përgjithshme të mallrave të importit për tremujorin e parë të vitit 2004, kanë rënë me 6 për qind ndaj tremujorit të parë të vitit 2003 dhe me 17 për qind ndaj tremujorit të katërt të vitit 2003.

**Tabela 7. Ndryshimi në çmimet e mallrave të importit<sup>6</sup> (në përqindje).**

	Pesha në vlerën e importeve gjithsej (në %)	T1'04/T4'03 (në %)	T1'04/T1'03 (në %)
Produkte vegjetale	7.8	0.5	6.0
Ushqime të përgatitura	7.8	-13.25	-11.0
Tekstile dhe artikuj	11.1	-4.50	-5.0
Makineri dhe pajisje	16.9	0.6	4.0
Produkte minerale	9.6	0.4	-14.0
Total	100	-17.0	-6.0

Duke u nisur nga ecuria e çmimeve të importit për gjysmën e dytë të vitit 2003, mund të themi se për grupmallrat me peshë më të madhe në importet totale, pritet të konstatohet një rënie e ndjeshme e këtyre çmimeve, sidomos për tremujorin e tretë të vitit 2004. Kjo do të thotë që çmimet e importit, duke përfshirë efektet që mund të rrjedhin nga rritja e çmimit të naftës, pritet të mos ushtrojnë presione inflacioniste mbi çmimet e konsumit.

### **Shërbimet, të ardhurat, transfertat korente**

Tregtia e shërbimeve ka shënuar rritje si në kahun e importeve, ashtu edhe në atë të eksporteve, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2004. Llogaria e shërbimeve për periudhën ishte lehtësisht negative (-6 milionë usd). Si të ardhurat, ashtu edhe shpenzimet për shërbime, janë rritur pothuajse në të njëjtën masë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (rreth 40 për qind). Kjo rritje është e ndjeshme edhe nëse anashkalojmë efektin e kursit të këmbimit. Të ardhurat nga udhëtimet, 300 milionë dollarë, përfaqësojnë 60 për qind të hyrjeve, ndërsa shpenzimet për udhëtime, 265 milionë dollarë, përfaqësojnë 50 për qind të daljeve të përgjithshme në llogarinë e shërbimeve. Numri i udhëtarëve që kanë ardhur në Shqipëri nga jashtë, si edhe ai i rezidentëve që kanë kaluar pushimet jashtë shtetit, ka qenë ndjeshëm më i lartë në krahasim me vitin e kaluar. Të ardhurat në kategorinë e komunikacionit janë rritur, duke reflektuar rritjen e të ardhurave nga shërbimet e kryera nga radiotelevizionet vendase dhe nga Albtelekomi.

Kategoria e të ardhurave nuk ka shfaqur ndonjë zhvillim të dallueshëm nga gjashtëmujori i parë i vitit të kaluar. Bilanci i të ardhurave ka qenë rreth 70 milionë dollarë. Pjesa më e madhe e të ardhurave (44 nga 80 milionë usd) është siguruar nga kompensimi i punonjësve, ndërkohë që pjesa tjetër ka qenë prej të ardhurave nga investimet e portofolit dhe ato të rezervës.

Bilanci i transfertave korente vazhdon të jetë pozitiv. Hyrjet neto të transfertave korente kanë mbuluar rreth 60 për qind të deficitit tregtar prej 690 milionë dollarësh. Transfertat hyrëse private ishin rreth 8 për qind më të larta se ato të gjashtëmujorit të parë të vitit të kaluar. Duke pasur parasysh efektin e kursit, mund të thuhet se burimi

<sup>6</sup> Burimi: INSTAT: Indekset e vlerës njësi për importet dhe eksportet.

më i madh i financimit të shpenzimeve korente, është duke siguruar më pak të ardhura valutore për Shqipërinë. Prej kohësh tashmë, është vënë theksi, në domosdoshmërinë e sigurimit të burimeve alternative të financimit të shpenzimeve, në mënyrë që të zbutet varësia ndaj një burimi jo të sigurt dhe të qëndrueshëm valute.

### **Llogaria kapitale dhe financiare dhe mjetet e rezervës**

Flukset neto në llogarinë kapitale dhe financiare, gjatë gjashtëmujorit të parë, ishin 267 milionë dollarë. Nga këto, rreth 60 milionë ishin hyrje neto në formën e kapitalit, kurse 207 milionë dollarë, hyrje neto në llogarinë financiare. Llogaria financiare në këtë periudhë regjistroi një rritje të ndjeshme të detyrimeve të rezidentëve në formën e investimeve direkte, si pasojë e derdhjes në buxhetin e shtetit të të ardhurave të privatizimit të ish-Bankës së Kursimeve në muajin prill të këtij viti. Rritje në detyrimet e rezidentëve është vënë re edhe në huamarrjen e re zyrtare dhe private, me përkatesisht 42 dhe 35 milionë dollarë. Gjatë tremujorit të dytë, Shqipëria ka shlyer rreth 23 milionë dollarë nga borxhi i saj i jashtëm. Në anën e mjeteve, vlejnë për t'u përmendur: rritja e stokut të depozitave të rezidentëve jashtë me 38 milionë dollarë, rritja e mjeteve të tjera me 32 milionë dollarë si edhe rritja me 10 milionë dollarë e mjeteve tona jashtë në formën e kapitalit aksioner.

Mjetet e rezervës janë rritur me 132 milionë dollarë, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2004. Pothuajse e gjithë kjo rritje ka qenë në monedhë të huaj, ndërkohë që zotërimet në ar, në SDR si edhe pozicioni rezervë në Fond, kanë mbetur të pandryshuara.

### **II.2.4 Tregu i punës**

Tregu i punës shfaq shenja stabilizimi gjatë tremujorit të dytë të vitit 2004. Rënia prej 11 mijë vetësh në forcat e punës gjatë tremujorit të parë, u pasua nga një rritje prej 1 mijë vetësh gjatë tremujorit të dytë. Zhvillimet e tremujorit të parë mund të shpjegohen deri-diku me vështirësitë logjistike në regjistrimin e subjekteve private gjatë kësaj periudhe. Deri në fund të tremujorit të dytë të vitit 2004, në forcat e punës në Shqipëri janë regjistruar 1.081 milionë persona, nga të cilët 921 mijë kanë qenë të punësuar. Rreth 20 për qind e këtyre personave janë të punësuar në sektorin shtetëror, 23 për qind në sektorin privat jobujqësor dhe 58 për qind në sektorin privat bujqësor. Norma e papunësisë ka shënuar rënie nga 14.9 për qind në fund të tremujorit të parë në 14.8 për qind në fund të tremujorit të dytë. Kjo rënie ka ardhur si pasojë e rritjes së njëkohshme të numrit të forcave të punës dhe e numrit të të papunëve.

Vihet re se punësimi në sektorin shtetëror ka ardhur në rënie, ndërkohë që forcat e lira të punës duket se po zhvendosen drejt sektorit privat jobujqësor. Megjithëse të dhënat zyrtare për tregun e punës publikohen me vonesë, sinjalet që vijnë nga zyrat rajonale të punës (në mënyrë të veçantë ato për qarkun e Tiranës) tregojnë se punësimi pritet të jetë në rritje për pjesën e mbetur të vitit. Në të njëjtën kohë, ky vit përkon me një fushatë të organizuar nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale për regjistrimin e punës së zezë dhe për forcimin e kontrollit nga ana e organeve tatimore. Këto hapa pritet të japin ndikimin e tyre edhe në të dhënat për tregun e punës.

**Tabela 8. Treguesit e tregut të punës (në mijë vetë).**

	2002				2003				2004	
	Tr.I	Tr.II	Tr.III	Tr.IV	Tr.I	Tr.II	Tr.III	Tr.IV	Tr.I	Tr.II
Forcat e punës gjithsej (në mijë)	1096	1093	1094	1094	1096	1093	1092	1091	1080	1081
A. Të punësuar gjithsej (në mijë)	918	917	919	921	926	927	928	927	919	921
i) në sektorin shtetëror	189	188	187	187	185	185	184	182	179	179
ii) në sektorin privat jobujqësor	6	203	206	208	207	208	210	211	206	208
iii) në sektorin privat bujqësor	526	526	526	526	534	534	534	534	534	534
B. Papunësia (në mijë)										
i) të papunë gjithsej	178	176	175	173	170	166	164	164	161	160
ii) përfitojnë pagesë papunësie	13	13	12	11	11	11	11	11	11.5	12
C.Shkalla e papunësisë (në %)	16.2	16.1	16.0	15.8	15.5	15.2	15.0	15.0	14.9	14.8

Burimi: Instat, Konjuktura qershor, 2003.




### III. ECURIA E INFLACIONIT DHE POLITIKA MONETARE

Presionet inflacioniste kanë qenë të ulta gjatë tremujorit të tretë. Norma e inflacionit ka shënuar një ulje graduale, duke arritur në kufirin e poshtëm të intervalit objektiv të Bankës së Shqipërisë, 2 – 4 për qind, në fund të tremujorit të tretë. Edhe inflacioni mesatar vjetor ka qenë në rënie, duke arritur vlerën 3.1 për qind në muajin shtator.

**Tabela 9. Norma vjetore e inflacionit (në për qind).**

	2000	2001	2002	2003	2004
Janar	-1.3	2.2	6.5	0.0	3.3
Shkurt	-1.3	1.5	7.6	1.1	4.4
Mars	-2.1	2.9	7.5	1.3	4.0
Prill	-1.4	3.0	6.5	2.3	3.2
Maj	-0.1	2.5	4.6	2.8	2.6
Qershor	0.1	4.0	3.7	2.6	2.9
Korrik	-1.3	5.6	4.2	3.0	3.1
Gusht	-0.7	4.1	5.5	3.0	2.7
Shtator	0.9	3.5	5.3	2.8	2.0
Tetor	1.8	1.8	5.8	2.9	
Nëntor	1.9	2.8	3.7	3.4	
Dhjetor	4.2	3.5	1.7	3.3	
Mesatar	0.05	3.13	5.22	2.37	3.13

**Grafik 4. Inflacioni vjetor (në për qind).**




Ecuria e çmimeve të konsumit gjatë kësaj periudhe është kushtëzuar ndjeshëm nga rritja e prodhimit bujqësor vendas. Kjo rritje ka bërë që kërkesa e shtuar e muajve të verës të plotësohet me prodhimin vendas, i cili ka përgjithësisht çmime më të ulta se importi. Si rezultat, në ndryshim nga vitet e kaluara (shih grafikun 5), kontributi i grupit 'Ushqim dhe pije joalkolike' në inflacionin total ka qenë negativ gjatë tremujorit të tretë. Nga ana tjetër, kushtet e përgjithshme makroekonomike: situata monetare, kërkesa e ekonomisë dhe situata fiskale kanë qenë nën kontroll, duke favorizuar ruajtjen e stabilitetit të çmimeve.

#### III.1 Ecuria e grupeve përbërëse të shportës së çmimeve të konsumit.

Inflacioni vjetor i grupit me peshën më të madhe – 'Ushqime dhe pije alkolike', ka shënuar vlera negative gjatë gjithë tremujorit të tretë. E njëjta gjë është vënë re edhe për grupin 'Veshje dhe këpucë'. Nga ana tjetër, grupet 'Qira, ujë, lëndë djegëse dhe

energji' dhe 'Transport' kanë regjistruar norma vjetore pozitive të inflacionit gjatë secilit prej muajve korrik, gusht, shtator.

**Grafik 5. Kontributi i grupeve kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje).**



Në muajin shtator, inflacioni vjetor i grupit 'Ushqime dhe pije joalkolike', shënoi -2.9 për qind, duke kontribuar me -1.25 pikë përqindjeje në normën vjetore të inflacionit total. Efekti sezonal i rënies së çmimeve të produkteve bujqësore u ndje më i fortë gjatë tremujorit të tretë të këtij viti. Gjatë periudhës maj – shtator 2004, prodhimi bujqësor vendas plotësoi në një masë të madhe nevojat e tregut. Gjithashtu, çmimet e prodhimit të industrisë përpunuese ushqimore<sup>7</sup>, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2004, kanë shënuar një rënie vjetore prej 28.7 për qind. Ecuria mujore e inflacionit të grupit 'Ushqim dhe pije joalkolike', si dhe e përbërësve të tij, paraqitet në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 10. Norma mujore dhe vjetore e grupit "Ushqim dhe pije alkolike".**

	"Ushqim dhe pije joalkolike"		Nëngrupi "Fruta"		Nëngrupi "Zarzavate"	
	Mujore	Vjetore	Mujore	Vjetore	Mujore	Vjetore
Korrik '04	-0.4	-0.1	3.7	10.9	-5.9	-15.4
Korrik '03	-1.0	6.2	-2.2	19.2	-3.9	30.1
Gusht '04	-1.2	-1.4	-5.5	7.8	-5.4	-21.3
Gusht '03	0.0	6.2	-2.7	17.4	1.7	26.1
Shtator'04	0.0	-2.9	-4.4	3.2	3.5	-25.6
Shtator '03	1.6	5.3	-0.1	22.5	9.4	21.4

Inflacioni i grupit 'Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji', ka qenë relativisht i qëndrueshëm, gjatë tremujorit të tretë të vitit. Megjithatë, ky grup përbën kontribuesin kryesor në inflacionin total, duke kontribuar me rreth 2.5 pikë përqindjeje në vlerën finale të inflacionit në muajin shtator (shih grafikun 5). Rritja e menjëhershme e inflacionit vjetor të nëngrupit 'Lëndë djegëse dhe energji' nga 6.9 për qind në muajin janar në 35 për qind në muajin shkurt të këtij viti, ka bërë që niveli i inflacionit i të gjithë grupit të vazhdojë të mbetet në nivel të lartë përgjatë muajve në vazhdim (shih tabelën 11).

<sup>7</sup> Të dhënat janë marrë nga IÇP tremujori i dytë 2004, INSTAT.


Tabela 11. Norma mujore dhe vjetore e grupit 'Qira, ujë, lëndë djegëse, energji'.

	" Qira, ujë, lëndë djegëse, energji"		"Qira"		'Lëndë djegëse dhe energji'	
	Mujore	Vjetore	Mujore	Vjetore	Mujore	Vjetore
Janar '04	0.0	3.7	0.0	2.6	0.3	6.9
Shkurt '04	4.9	8.5	-0.5	2.1	26.4	35.0
Mars'04	0.0	8.3	0.0	2.1	-0.1	35.0
Prill '04	2.4	11.0	3.5	5.6	0.1	35.1
Maj' 04	0.0	9.7	0.0	5.6	0.0	27.2
Qershor'04	0.0	9.7	0.0	5.6	-0.1	27.0
Korrik '04	0.1	9.9	0.0	5.6	-0.1	26.9
Gusht '04	0.8	9.7	1.1	5.5	0.0	26.7
Shtator'04	0.0	10.4	0.0	6.4	-0.1	26.7

Rritja e çmimit të naftës në tregjet botërore, gjatë këtij tremujori, rrezikoi të përkthehej në rritje të inflacionit të grupit 'Transport', duke patur implikime negative edhe për vlerën e inflacionit total. Por, inflacioni i këtij grupi shënoi vetëm një rritje të lehtë gjatë kësaj periudhe. Inflacioni mujor i muajit gusht ishte vetëm 1.4 për qind, i ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së çmimit të shërbimeve të transportit dhe shërbimeve ndaj mjeteve personale. Ndërkohë, efekti i rritjes së çmimit të naftës mendohet të jetë balancuar nga mbiçmimi i lekut ndaj dollarit në tregun e brendshëm<sup>8</sup>.

Rritja e tarifave të administruara të telefonisë fikse<sup>9</sup> ka bërë që inflacioni vjetor i grupit 'Komunikim' të qëndrojë në 17 për qind gjatë pjesës më të madhe të vitit. Ndërkohë, kontributi i grupeve të tjera në vlerën e inflacionit total ka qenë modest.

Grafik 6. Inflacioni vjetor i 4 grupeve kryesore të shportës së IÇK-së (në për qind).




<sup>8</sup> Dollari është nënçmuar mesatarisht me 3.5 për qind ndaj lekut gjatë tremujorit të tretë, në krahasim me tremujorin e dytë të këtij viti.

<sup>9</sup> Rritja fillestare e tarifave të administruara të telefonisë fikse, në muajin dhjetor 2003, u korrigjua në ulje në muajin prill.

### III.2 AMBIENTI MAKROEKONOMIK DHE ÇMIMET E KONSUMIT.

Me përjashtim të muajit shkurt, norma vjetore e inflacionit ka qenë brenda objektivit 2 – 4 për qind të Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2004. Kjo ecuri pozitive, pa dyshim që është kushtëzuar edhe nga ekuilibrat makroekonomikë që janë ruajtur gjatë vitit 2004. Politika monetare dhe fiskale e kujdesshme, kanë krijuar kushte të përshtatshme për mbajtjen e inflacionit nën kontroll. Gjatë vitit 2004 në përgjithësi, dhe gjatë tremujorit të tretë janë respektuar nivelet e programuara të shpenzimeve dhe të deficitit buxhetor, të bëra nga qeveria.


**Grafik 7. Rritja vjetore e shpenzimeve buxhetore (në përqindje).**



Deri në muajin shtator 2004, shpenzimet në total janë realizuar në masën 91 për qind, ndërsa deficieti buxhetor në masën 82 për qind. Kërkesa e qeverisë për financimin e deficitit ka qenë relativisht e njëtrajtshme gjatë vitit. Ajo nuk krijoi shformime në situatën e likuiditetit dhe për pasojë, nuk ka ushtruar presione inflacioniste.

Banka e Shqipërisë ka qenë e kujdesshme në zbatimin e politikës monetare. Situata e likuiditetit ka qenë e qëndrueshme, normat e interesit, megjithë rënien e tyre, kanë vijuar të favorizojnë rritjen e depozitave në lekë dhe kthimin e parasë në sistemin bankar. Nga ana tjetër, rritja e moderuar e ofertës monetare, ka plotësuar më së miri rritjen e kërkesës për para, karakteristikë sezonale për këtë periudhë.

**Grafik 8. Ndryshimet vjetore të agregatëve monetarë M1 dhe M3 (në përqindje).**



Kërkesa vendase për mallra ushqimorë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit është plotësuar pa sforcim nga ana e ekonomisë shqiptare<sup>10</sup>. Rritja e prodhimit të brendshëm ka çuar në zëvendësimin e mallrave bujqësorë të importuar me mallra vendi, të cilët kanë edhe çmime më të ulëta. Kërkesa e ulur për importe të kësaj natyre ka ruajtur të ulur kërkesën për valutë, gjë që ka shkaktuar mbiçmimin e

<sup>10</sup> Importet e mallrave bujqësorë gjatë kësaj periudhe, kanë qenë pothuajse të njëjta në terma nominalë me ato të së njëjtës periudhë të vitit të kaluar.

mëtejshëm të lekut<sup>11</sup>. Ky faktor, i kombinuar me vlerat e qëndrueshme të inflacionit në vendet kryesore partnere të mallrave të importit, ka ndikuar në uljen e vlerës së inflacionit të importuar gjatë vitit 2004.


**Tabela 12. Inflacioni vjetor i vendeve kryesore partnere (në përqindje).**

	Janar '04	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht
Greqi	3.1	2.6	2.9	3.1	3.1	3.0	3.1	2.8
Itali	2.2	2.4	2.3	2.3	2.3	2.4	2.2	2.4

Burimi: Eurostat News Release.

Në këto kushte, rritja e kërkesës<sup>12</sup> si dhe kushtet e tregut me pakicë<sup>13</sup> nuk ndikuan përçimin e presioneve inflacioniste në çmimet e konsumit. Gjithsesi, mbetet për t'u vlerësuar në të ardhmen ndikimi i mundshëm i rritjes së çmimeve të pasurive të patundshme në reduktimin e kërkesës së brendshme për mallra konsumi. Kjo rritje çmimesh mund të ndikojë në zhvendosjen e strukturës së konsumit të një pjese të shoqërisë drejt pasurive të patundshme. Nga ana tjetër, rritja e indeksit të çmimeve të prodhimit<sup>14</sup> në tremujorin e dytë të vitit 2004, nuk ka përcjellë impulse rritëse në çmimet e konsumit.

**Grafik 9. Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Prodhimit.**



### III.3 POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË.

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka patur një kah të qartë lehtësues gjatë tremujorit të tretë të vitit. Niveli i kontrolluar i inflacionit dhe parashikimet optimiste për përmbushjen e objektivit të Bankës së Shqipërisë, kanë diktuar nevojën e rishqyrtimit të qëndrimit të politikës monetare. Banka e Shqipërisë ka ulur, në tre hapa, me 0.75 pikë përqindjeje normën bazë të interesit gjatë gjysmës së parë të vitit. Megjithatë, analiza e kushteve monetare dhe e faktorëve që ndikojnë në inflacion, sugjeroi se kishte hapësirë për ulje të mëtejshme të normës bazë të interesit.

<sup>11</sup> Në muajin shtator 2004, leku në terma vjetorë është mbiçmuar ndaj dollarit dhe euros përkatësisht me 15.1 për qind dhe 7.6 për qind.

<sup>12</sup>Kërkesa, e parë si niveli i shitjeve i realizuar nga të gjithë sektorët e ekonomisë, ka pësuar një rritje prej 19.6 për qind në tremujorin e dytë të vitit 2004 krahasuar me tremujorin paraardhës. Burimi: Indeksi i shitjeve, INSTAT.


<sup>13</sup>Indeksi i volumit të shitjeve në tregtinë me pakicë, në tremujorin e dytë të këtij viti u rrit 26.8 për qind në krahasim me tremujorin e parë dhe 28.2 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës.

Burimi: Indeksi i volumit, INSTAT.

<sup>14</sup> Të dhënat nga INSTAT.


Kështu, norma e rritjes vjetore të agregatit M1 real (agregati monetar i cili është provuar se ka ndikimin më të madh në inflacion) vazhdon të mbetet poshtë mesatares historike disavjeçare. Gjithashtu, niveli i ulët i inflacionit dhe stabilizimi i pritjeve inflacioniste të ekonomisë<sup>15</sup> për këtë nivel, kanë bërë që niveli i normës reale të interesit të jetë relativisht i lartë, edhe pas uljeve të normave nominale të interesit. Kjo ka bërë rritur interesin për depozitimin e kursimeve në sistemin bankar, duke sjellë një zhvendosje të strukturës së likuiditetit drejt mjeteve monetare afatgjata, depozita dhe bono thesari (grafiku 10). Atraktiviteti i normave të interesit në lekë në krahasim me ato në valutë, në prani të një oferte të rritur të valutës gjatë muajve të verës, ka ushtruar presione për mbiçmimin e lekut.

**Grafik 10. Ecuria e kushteve monetare në ekonomi.**



Në përgjigje të këtyre zhvillimeve, Banka e Shqipërisë uli normën bazë të interesit me 0.25 pikë përqindjeje në datën 28 korrik. Kjo ulje u bë në përputhje me politikën e deklaruar të Bankës së Shqipërisë për të ruajtur në ekonomi një nivel sa më të ulët normash interesi, i cili të jetë konsistent me objektivin e stabilitetit të çmimeve në një periudhë afatmesme. Pas kësaj uljeje, norma bazë e interesit zbriti në 5.5 për qind, niveli më i ulët i saj i aplikuar në Shqipëri.

**Grafik 11. Norma bazë e interesit në Shqipëri.**



<sup>15</sup> Vrojtimet e Bankës së Shqipërisë me konsumatorët, bizneset dhe sistemin bankar dëshmojnë përgjithësisht për pritje të ulta inflacioniste në ekonomi.

Reagimi i sistemit bankar ndaj uljes së normës bazë të interesit ka qenë i kënaqshëm. Normat e interesit të depozitave në lekë dhe të bonove të thesarit janë reduktuar, duke reflektuar edhe uljen e mëparshme të normës bazë të interesit<sup>16</sup>.

**Tabela 13. Reagimi i sistemit bankar ndaj zbutjes së fundit të politikës monetare.**

	3 mujore	6 mujore	12 mujore
Depozita	-0.13	-0.49	-0.47
Bono thesari	-0.73	-0.61	-0.76

Megjithatë, reagimi i sistemit bankar ka qenë i ngadaltë dhe Banka e Shqipërisë e ka mbështetur uljen e normës bazë të interesit edhe me operacionet e saj në tregun ndërbankar. Banka e Shqipërisë ka aplikuar gjatë muajve korrik-gusht ankande reposh me shumë të kufizuar, për të rritur presionin e uljes së normave të interesit mbi bankat e nivelit të dytë. Ndërkohë, të dhënat tregojnë se normat e interesit të kredive në lekë nuk e kanë ndjekur këtë zbutje të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë. Kjo dukuri është e lidhur më shumë me fragmentarizimin e tregut të kredive dhe me zhvendosjen e strukturës së tyre drejt kredive më afatgjata. Ndërkohë, me kalimin e kohës pritet që të ulen edhe normat e interesit në tregun e kredive në lekë.

Tremujori i tretë shënoi një forcim të presioneve mbiçmuese ndaj kursit të këmbimit të lekut. Këto presione janë rritur veçanërisht nga hyrjet e mëdha të valutës gjatë kësaj periudhe. Kështu, depozitat në valutë janë rritur me 10.5 miliardë lekë ose afërsisht 100 milionë usd gjatë muajve korrik-gusht. Oferta e rritur e valutës është përballur me një kërkesë të zbehur, si pasojë e uljes së importeve dhe e preferencës për lekun për shkak të diferencës së normave të interesit. Në këto kushte, Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë në tregun valutor në kahun e blerjes së valutës, duke tërhequr ofertën e tepërt të saj dhe duke injektuar likuiditete në lekë. Ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor ka qenë në përputhje me politikën monetare zbutëse. Nga ana tjetër, reduktimi i normës bazë të interesit gjatë vitit 2004 ka zbutur intensitetin e veprimtimit të këtij faktori, i cili ka favorizuar forcimin e lekut.

Banka e Shqipërisë ka respektuar edhe objektivat e saj sasiorë gjatë tremujorit të tretë.

**Tabela 14. Objektivat sasiorë të Bankës së Shqipërisë.**

	Dhjetor '03	Mars '04	Qershor '04	Korrik'04	Gusht'04
Rezerva ndërkombëtare neto e Bankës së Shqipërisë (në milionë dollarë).					
Objektivi	715.8	751.8	765.8	818.4	871.1
Aktuale	832.7	827.6	961.5	986.4	1041.9
Diferenca	116.8	75.8	195.7	168.0	170.9
Mjetet e brendshme neto të Bankës së Shqipërisë (në miliardë lekë).					
Objektivi	96.0	83.0	85.0	80.0	75.0
Aktuale	72.0	66.4	54.7	56.4	59.5
Diferenca	-24.0	-16.6	-30.3	-23.6	-15.5
Kredia e brendshme neto për qeverinë (në miliardë lekë).					
Objektivi	280.9	274.1	270.1	273.1	276.1
Aktuale	268.1	273.9	263.6	267.5	268.3
Diferenca	0.0	-0.2	-6.5	-5.6	-7.8


<sup>16</sup> Ulja e mëparshme, e treta për vitin 2004, është bërë në muajin qershor.

## IV. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE

### IV.1 OFERTA MONETARE DHE AGREGATËT MONETARË

Norma e rritjes vjetore së ofertës monetare ka shënuar një rritje të dukshme gjatë periudhës qershor–gusht, duke arritur në nivelin 10 për qind, nga 8.1 për qind që ishte niveli mesatar i saj në gjysmën e parë të vitit. Rritja e ofertës monetare në këtë periudhë është ndikuar nga rritja e pjesës në lekë të saj, ndërsa rritja vjetore e depozitave në valutë ka vazhduar të jetë e lartë por në nivele të qëndrueshme. Flukset e mëdha hyrëse të valutës dhe rritja e tendencës mbiçmuese e lekut, janë shoqëruar me ndërhyrjen e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor. Kjo ka sjellë injektimin, në sasi të konsiderueshme, të likuiditetit në ekonomi, duke ndikuar në rritjen e agregatit M2 dhe plotësimin e kërkesës për mjete monetare në lekë. Ecuria e raporteve të përbërësve të ofertës monetare ka reflektuar kryesisht ndikimet sezonale të periudhës, të cilat janë shfaqur në rritjen e peshës së parasë jashtë bankave dhe depozitave në valutë në parandikim të gjatë.

**Grafik 12. Ecuria e normave vjetore të agregatëve monetarë.**




Flukset valutore nga turizmi dhe dërgesat e emigrantëve vlerësohen të kenë shënuar rritje në krahasim me vitin e kaluar, dëshmuar kjo edhe nga normat vjetore të rritjes së depozitave në valutë gjatë tre muajve të verës së këtij viti më të larta se ato të një viti më parë. Në periudhën qershor-gusht 2004, niveli mesatar i rritjes së depozitave në valutë është luhatur në 12.7 për qind ndërsa një vit më parë në po këtë periudhë ky tregues ishte 11.9 për qind. Mbiçmimi vjetor i lekut kundrejt euros dhe usd-së, ka ndikuar negativisht nivelin e depozitave në valutë në muajin gusht me 13.7 miliardë lekë. Në mungesë të këtij efekti norma vjetore e rritjes së tyre do të rezultonte 25.3 për qind.

Depozitat në lekë gjatë periudhës qershor-gusht kanë manifestuar rritje. Norma vjetore e rritjes së tyre në muajin gusht arriti në 11.5 për qind, nga 9.5 për qind në muajin qershor. Rritja e depozitave në lekë ka reflektuar atraktivitetin e normave më të larta të interesit në lekë krahasuar me ato në valutë, duke bërë që një pjesë e flukseve valutore nga jashtë të investohen në asete financiare në lekë (depozita dhe bono thesari). Gjithashtu, një tjetër faktor që vlerësohet të ketë ndikuar në rritjen e depozitave në lekë dhe të depozitave në përgjithësi, është edhe përmirësimi dhe shtimi i shërbimeve bankare për klientët, gjë që ka rritur shkallën e përdorimit të bankave nga ana e tyre. Ndikimi i këtij faktori vihet re në ecurinë e depozitave pa afat të individëve dhe të sektorit privat, të cilat muajt e fundit kanë shfaqur një tendencë në rritje.



**Grafik 13. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj M3.**



Norma vjetore e rritjes së parasë jashtë bankave ka pësuar një rritje të ndjeshme në muajt korrik dhe gusht, si pasojë e injektimit të likuiditetit në treg nga ndërhyrjet valutore të Bankës së Shqipërisë. Kjo situatë ka përkuar me rritjen sezonale të kërkesës për para fizike, si rezultat i shpenzimeve të larta konsumatore gjatë muajve të verës, duke bërë që niveli i lartë i parasë jashtë bankave të jetë i qëndrueshëm. Në muajin gusht, norma e rritjes vjetore të parasë jashtë bankave iu rikthye niveleve pozitive, duke u rritur në 5.5 për qind, nga -0.6 për qind që ishte në muajin qershor. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj M3 arriti në 26.6 për qind, duke shënuar një rritje me 0.8 pikë përqindjeje kundrejt nivelit të muajit qershor.

**Tabela 15. Ecuria e treguesve monetarë në muajin gusht (në miliardë lekë).**

	Gusht 2004	Ndryshimi 2-mujor		Ndryshimi vjetor	
		Absolut	Përqindje	Absolut	Përqindje
Paraja jashtë bankave	128.9	10.6	9.1	6.8	5.5
Depozitat totale	356.2	16.3	4.8	37.2	11.7
- në lekë	241.2	5.8	2.5	24.9	11.5
- në valutë	115.0	10.5	10.2	12.3	11.9
Depozita pa afat	70.8	5.8	9.1	11.5	19.3
- në lekë	25.1	2.7	11.6	5.6	28.6
- në valutë	45.7	3.1	7.6	5.9	14.8
Depozita me afat	285.4	10.5	3.8	25.7	9.9
- në lekë	216.1	3.0	1.4	19.3	9.8
- në valutë	69.3	7.5	11.9	6.4	10.2
M1	154.0	13.4	9.5	12.4	8.7
M2	370.1	16.4	4.7	31.7	9.4
M3	485.1	26.9	5.9	43.9	10.0
Baza monetare	170.3	13.3	8.6	13.8	8.8


## IV.2 KËRKESA E EKONOMISË PËR MJETE MONETARE

### IV.2.1 Pozicioni valutor i sistemit bankar

Pozicioni valutor i sistemit bankar është përmirësuar gjatë vitit 2004. Sistemi bankar rezulton me rritje prej 209.3 milionë usd<sup>17</sup> të mjeteve valutore neto gjatë periudhës korrik – gusht. Rritja e mjeteve valutore neto në muajin gusht ka dhënë një kontribut prej 64 për qind në rritjen e M3, kontributi më i lartë për vitin 2004.

Kontributin më të madh në këtë rritje e kanë dhënë bankat e nivelit të dytë, me një rritje prej 127.4 milionë dollarësh në nivelin e mjeteve valutore neto. Rritja e mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë ka ardhur kryesisht nga rritja e depozitave në valutë gjatë kësaj periudhe, si pasojë e rritjes së prurjeve të emigrantëve. Gjithashtu, ndikim në këtë periudhë ka patur dhe konvertimi në euro i një pjese të kapitalit të Bankës së Kursimeve. Banka e Shqipërisë ka ritur gjithashtu nivelin e rezervës valutore neto. Për periudhën korrik – gusht, kjo rritje është 81.8 milionë dollarë. Prania e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor në kahun e blerjes së valutës ka ndikuar në rritjen e rezervës valutore. Banka e Shqipërisë ka patur si partner kryesor bankat e nivelit të dytë gjatë ndërhyrjeve në tregun valutor.

Grafik 14. Mjetet valutore të sistemit bankar (në milionë usd).




### IV.2.2 Kërkesa e qeverisë për para.

Muajt korrik-gusht janë shoqëruar me rritje të kërkesës së qeverisë për mjete monetare. Deficiti buxhetor arriti në 11.6 miliardë lekë në muajin gusht, duke u rritur me 4.5 miliardë krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2004. Kjo kërkesë e qeverisë ka vazhduar të mbulohet pothuajse tërësisht nga financimi i brendshëm, i cili, gjatë muajve korrik – gusht, ishte 3.6 miliardë lekë. Sistemi bankar ka financuar qeverinë me anë të blerjeve të bonove të thesarit dhe obligacioneve qeveritare. Bankat e nivelit të dytë kanë ulur portofolin e bonove të thesarit në masën 1.6 miliardë lekë. Ulje të portofolit të bonove të thesarit kanë patur edhe institucionet, ndërsa Banka e Shqipërisë dhe individët i kanë ritur lehtësisht portofolet e tyre. Niveli i obligacioneve qeveritare të emetuara në periudhën korrik-gusht është 1.6 miliardë lekë.

Banka e Shqipërisë, në mbështetje të politikës së saj monetare, ka përdorur edhe financimin direkt në masën 0.5 miliardë lekë gjatë periudhës korrik – gusht për të mbuluar një pjesë të deficitit buxhetor. Gjithashtu për llogari të qeverisë, kanë kaluar edhe një pjesë e të ardhurave nga privatizimi i Bankës së Kursimeve, rreth 0.6 miliardë lekë.

<sup>17</sup> Duke mënjanuar efektin e kursit të këmbimit kjo rritje llogaritet 218 milionë dollarë.

**Grafik 15. Financimi i deficitit buxhetor (në miliardë lekë).**



#### IV.2.3 Kredia për ekonominë.

Ndërmjetësimi në procesin e financimit të sektorit prodhues të ekonomisë është një nga funksionet kryesore të sistemit bankar. Megjithëse kreditimi i ekonomisë nga sistemi bankar mbetet ende larg niveleve të vendeve të zhvilluara, duhet theksuar se kredia për ekonominë ka shënuar rritje të shpejtë gjatë tre viteve të fundit. Kreditimi i ekonomisë në raport me PPB-në ka shënuar rritje të vazhdueshme, duke reflektuar një angazhim më të madh të kursimeve në financimin e aktivitetit ekonomik. Në fund të muajit gusht 2004, teprica e kredisë arriti në 60.9 miliardë lekë (7.3 për qind e PBB-së). Gjithashtu, vihet re një rritje e numrit të bankave të angazhuara në tregun e huadhënies bankare.

Sistemi bankar, në periudhën janar-gusht 2004, tregoi ritme të larta të kreditimit të ekonomisë. Pjesa që zë krediti për ekonominë në kërkesën për para ka ardhur duke u rritur, në një kohë që kredia për qeverinë ka patur tendencë rënëse. Në fund të muajit gusht të vitit 2004, kredia për ekonominë përbën rreth 13 për qind të kërkesës për para. Interesimi i bankave për investimin e burimeve të tyre në tregun e huadhënies ka ardhur në rritje të vazhdueshme. Këtë fakt e mbështet dhe rritja e vazhdueshme e raportit kredi / depozita, i cili në muajin gusht të vitit 2004 është rritur me 1.4 pikë përqindjeje krahasuar me fundin e vitit 2003.

**Tabela 15. Ecuria e disa treguesve kryesorë<sup>18</sup>.**

	2002	2003	T-1'04	T-2'04	Korrik'04	Gusht '04
Oferta e parasë (në miliardë lekë)	416.7	448.4	456.0	458.2	469.9	485.1
Kredi e brendshme (në % ndaj M3)	70.8	71.5	71.6	69.5	69.1	66.9
- Kredi për qeverinë (në % ndaj M3)	61.5	60.2	59.9	57.1	56.3	54.3
- Kredi për ekonominë (në % ndaj M3)	9.3	11.3	11.7	12.4	12.8	12.6
Kredi për ekonominë (% ndaj totalit të aktiveve)	11.5	13.7	13.7	14.6	15.1	15.0
Kredi për ekonominë (në % ndaj PBB)	5.7	6.8	7.0	7.4	7.2	7.3
Depozita gjithsej (në % ndaj PBB)	42.2	43.4	44.1	44.1	41.3	42.6
Raporti kredi/depozita (në %)	13.5	15.7	15.8	16.7	17.4	17.1

Teprica e kredisë u rrit 4.1 miliardë lekë gjatë periudhës korrik-gusht 2004. Kjo rritje rezultoi 51 për qind më e lartë se rritja e saj gjatë së njëjtës periudhë të vitit të kaluar.

<sup>18</sup> Ky raport është ndërtuar ndaj PBB në nivel vjetor për vitin 2004.

Teprica e kredisë është rritur me 10.2 miliardë lekë gjatë vitit 2004 ose rreth 20 për qind më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit 2003.

Struktura e tepricës së kredisë sipas afateve vazhdoi të pësojë ndryshime në drejtim të rritjes së kredisë afatmesme dhe afatgjatë gjatë muajve korrik-gusht 2004. Sistemi bankar po orientohet gjithnjë e më shumë nga investimet afatmesme dhe afatgjata të fondeve të tij, duke kontribuar më shumë në zhvillimin ekonomik të vendit. Në fund të muajit gusht, teprica e kredisë afatmesme dhe afatgjatë përbënte 65 për qind të tepricës së kredisë, nga 54 për qind në fund të vitit 2003. Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave vazhdon të mbizotërohet nga kredia në valutë. Ndërkohë, vërehet një rritje e preferencës në marrjen e kredisë në monedhën evropiane. Kredia në euro përbën 55 për qind të kredisë totale në fund të muajit gusht 2004, nga 50 për qind në fund të vitit 2003.

**Tabela 17. Ecuria e treguesve të tepricës së kredisë, në përqindje.**

	2002	2003	T-1 '04	T-2 '04	Korrik '04	Gusht '04
Teprica e kredisë (në mld lekë)	38.7	50.7	53.4	56.8	60.0	60.9
Kredi afatshkurtër	53.8	46.0	41.6	35.4	35.6	35.0
Kredi afatmesme	30.1	33.3	35.4	37.8	37.4	38.0
Kredi afatgjatë	16.1	20.7	23.0	26.8	27.0	27.0
Lekë	21.3	19.6	17	17	16	16
Valutë	73.7	80.4	83	83	84	84

Kredia e re, e lëvruar gjatë muajve korrik-gusht të vitit 2004 është 12.2 miliardë lekë. Kredia afatshkurtër ka përbërë 62 për qind e kredisë së re të akorduar në këta dy muaj. Nga pikëpamja e strukturës sipas monedhave të kredisë së akorduar, kredia e re e akorduar në lekë zë 45.2 për qind të totalit të saj. Ndërkohë, për periudhën janar-gusht 2004 janë akorduar 68.6 miliardë lekë kredi ose 26 për qind më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

**Tabela 18. Ecuria e kredisë së re në vite (në miliardë lekë).**

	2002	2003	T-1 '04	T-2'04	Korrik- Gusht '04
Kredi e re (në mld lekë)	62.6	92.6	27.9	28.5	12.2
Kredi afatshkurtër	44.7	63.1	18.7	18.1	7.6
Kredi afatmesme	13.0	22.2	5.7	6.8	2.6
Kredi afatgjatë	4.8	7.4	3.5	3.6	2.0
Lekë	20.8	30.8	8.80	8.9	3.8
Valutë	41.8	61.8	19.10	19.6	8.4

Degët më të kredituara nga sistemi bankar vazhdojnë të jenë tregtia, industria përpunuese, pasuritë e patundshme dhe ndërtimi. Veçojmë se vërehet një tendencë rënëse e financimeve nga ana e bankave për aktivitete tregtare gjatë periudhës janar-gusht 2004, duke u orientuar në degë të tilla si industri përpunuese, bujqësi, hotele restorante etj.. Nga ana tjetër, sektori i bujqësisë ka filluar që të mbështetet më shumë financiarisht me kredi bankare. Megjithatë, përsëri natyra e aktiviteteve të bizneseve që operojnë me bankat, në përgjithësi, është më shumë tregtare se sa prodhuese.


Tabela 19. Teprica e kredisë sipas degëve të ekonomisë (në përqindje).

	2002	2003	T-1 '04	T-2'04	Korrik '04	Gusht '04
1 Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	0.8	1	1.0	1.2	1.4	1.4
2 Peshkimi	0.2	0	0.1	0.1	0.1	0.1
3 Industria nxjerrëse	0.2	1	0.2	0.2	0.2	0.2
4 Industria përpunuese	17.0	17	16.9	18.4	17.5	18.6
5 Prodhimi, shpërndarja energji elektrike, gaz dhe ujë	3.3	3	3.0	3.3	3.1	3.3
6 Ndërtimi	8.6	10	9.7	10.7	9.3	10.0
7 Tregtia, riparimi i automobilitave dhe artikujve shtëpiakë	40.4	34	31.4	23.5	22.5	22.9
8 Hotele dhe restorante	6.0	6	7.1	8.3	7.7	8.1
9 Transporti dhe telekomunikacioni	2.4	1	2.0	1.5	1.4	1.3
10 Aktivitete financiare	-	0	0.1	0.7	0.8	0.7
11 Pasuritë e patundshme	9.1	13	13.7	14.8	15.5	16.0
12 Shëndeti dhe veprimtaritë sociale	0.5	0	0.5	0.5	0.6	0.5
13 Shërbime kolektive, sociale dhe personale	4.2	8	4.2	4.5	4.4	4.5
14 Të tjera	7.3	4	10.1	12.2	15.4	12.3
Totali	100	100	100.0	100.0	100.0	100.0

### IV.3 ZHVILLIMET NË TREGJET FINANCIARE

Norma bazë e interesit u ul në 5.50 për përqind, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2004. Normat e interesit në tregun e parasë, në përgjithësi, ndoqën të njëjtën tendencë duke rezultuar në fund të tremujorit të tretë në vlerat më të ulëta historike të tyre. Rënia e normave të interesit u mbështet dhe nga një tepricë likuiditeti në nivele të qëndrueshme gjatë gjithë periudhës.


Grafik 16. Normat e interesave në tregun e parasë.



#### IV.3.1 Ecuria e likuiditetit në treg

Rritja e depozitave në lekë dhe përdorimi i kredisë direkte për të financuar qeverinë, kanë bërë që niveli i likuiditetit të bankave tregtare të rritet në tremujorin e tretë. Niveli mesatar i likuiditetit gjatë kësaj periudhe arriti në vlerën e 6.4 miliardë lekëve nga 4.9 miliardë që ishte në tremujorin e dytë dhe 5.2 miliardë në tremujorin e parë të këtij viti.

Grafik 17. Likuiditeti i bankave tregtare (në milionë lekë)<sup>19</sup>.




Banka e Shqipërisë ka vazhduar të tërheqë likuiditet nga sistemi bankar nëpërmjet ankandeve javore të repove me maturitet njëjavor dhe njëmuajor. Vëllimi mesatar i fondeve të bankave tregtare të investuara në repo u rrit në 4.6 miliardë lekë në tremujorin e tretë nga 3.5 miliardë në tremujorin paraardhës.

Vëllimi i transaksioneve njëditore në tregun ndërbankar ka qëndruar pothuajse në të njëjtat nivele me ato të tremujorit të kaluar. Niveli mesatar i transaksioneve njëditore arriti 0.38 miliardë lekë nga 0.36 miliardë lekë në tremujorin e dytë dhe 0.3 miliardë lekë në tremujorin e parë. Niveli mesatar i transaksioneve 7-ditore në tregun ndërbankar, në tremujorin e tretë, arriti në 0.36 miliardë lekë nga 0.46 miliardë në tremujorin e dytë dhe 0.18 miliardë në tremujorin e parë.

Në tregun primar, investimi në bono thesari nga bankat dhe individët gjatë tremujorit të tretë ka ardhur në rritje. Vlera mesatare e investuar në këtë instrument për çdo ankand, gjatë kësaj periudhe, arriti në 11 miliardë lekë nga 9 miliardë lekë që ishte në tremujorin e dytë. Megjithatë, në këtë periudhë, kërkesa e qeverisë për financim është mbuluar dhe me kredi direkte, duke ndikuar në shtimin e likuditetit të tepërt të bankave.

**Grafik 18. Investimi në bono thesari, gjatë vitit 2004 (në milionë lekë).**



#### IV.3.2 Ecuria e normave të interesit

Normat e interesit kanë vijuar të ulen përgjatë gjithë vitit 2004, duke arritur vlerat më të ulëta në fund të tremujorit të tretë. Politika lehtësuese e ndjekur në këtë periudhë nga Banka e Shqipërisë është përcjellë në tregun e depozitave në lekë, në tregun primar dhe në tregun ndërbankar, ndërkohë që tregu i kredive nuk ka reaguar si duhet ndaj sinjaleve të politikës monetare. Rritja e normës së interesit për kursimet në valutë ka sjellë ngushtimin e spread-it midis monedhës vendase dhe asaj të huaj.

**Tabela 20. Ndryshimi i interesave mesatare të ponderuara gjatë vitit 2004 (në pikë përqindjeje).**


	Tremujori I	Tremujori II	Tremujori III	Total për nëntëmuajorin
Tregu ndërbankar 1-ditor	-0.61	-0.43	-0.20	-1.24
Tregu ndërbankar 7-ditor	-0.40	-0.30	-0.70	-1.40
Depozita në lekë (3, 6 & 12-mujor)	-0.31	-0.37	-0.31*	-0.68
Bono thesari (3, 6 & 12 mujor)	-0.22	-0.15	-0.56	-0.93
Kreditë në lekë	0.32	2.61	1.66**	2.93

\*të dhënat e interesave të depozitave në lekë për muajin shtator janë sipas të dhënave operative.

\*\*të dhënat më të fundit të tremujorit të tretë për interesat e kredive në lekë janë të muajit gusht 2004.

Norma e interesit për transaksionet njëditore në tregun ndërbankar zbriti në 3.07 për qind në fund të tremujorit të tretë, nga 5.4 për qind që ishte në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Niveli prej 2.76 për qind që u regjistrua në muajin shtator, shënoi nivelin më të ulët historik të këtyre interesave në tregun ndërbankar. Tregu primar, gjithashtu, shënoi vlerat më të ulëta të yield-it në këta dhjetë vitet e fundit. Yield-i mesatar i ponderuar i bonove të thesarit tre, gjashtë dhe dymbëdhjetëmujore, në fund të tremujorit të tretë, arriti përkatësisht në 6.30 për qind, në 7.56 për qind dhe në 8.43 për qind duke çuar në ngushtimin e diferencës midis normave të interesit të investimit në bono thesari dhe depozitave.

**Grafik 19. Normat e interesit afatgjatë në treg.**



Normat e depozitave me afat në lekë gjatë periudhës korrik-shtator janë ulur për të gjitha afatet. Megjithatë, kjo ulje nuk ka paraqitur problem për normat reale të depozitave, të cilat kanë mbetur pozitive si rrjedhojë e inflacionit të ulët. Që nga muaji maj 2003, norma e interesit reale për depozitat dymbëdhjetëmujore në lekë është luhatur rreth një niveli mesatar prej 3.8 për qind.

**Tabela 21. Interesat mesatarë të ponderuar të depozitave me afat në lekë (në përqindje).**

	shtator-03	dhjetor-03	mars-04	qershor-04	shtator-04*
3 mujore	6.17	5.49	5.21	4.89	4.73
6 mujore	7.50	7.07	6.57	6.10	5.85
12 mujore	7.83	7.62	7.03	6.52	6.27

\* të dhënat e muajit shtator janë operative ponderuar me fluksin e ri të depozitave të muajit gusht.

Nivelet e ulta të normave të interesit në tregje kanë ndikuar në uljen e kostos së borxhit të brendshëm të qeverisë, në uljen e kostos së huamarrjes ndërbankare, në ngushtimin e dallimeve midis interesave të depozitave në lekë me ato në valutë dhe në krijimin e hapësirave për uljen e kostos së kreditimit të ekonomisë. Megjithatë, norma mesatare e interesit për kreditë në lekë është rritur nga 14.3 për qind në muajin qershor në 15.9 për qind në muajin gusht (interesi mesatar i ponderuar për të gjitha afatet). Lulatjet e këtyre normave nga muaji në muaj lidhen si me hezitimin e bankave për t'i reduktuar menjëherë ato, ashtu dhe me peshën që zënë në kreditim banka të caktuara në periudha të caktuara.

Përsa i përket depozitave dhe kredive në valutë, gjatë tremujorit të tretë, u shënuan rritje të interesave në usd dhe në euro, thujse në të gjitha afatet. Këtu ka ndikuar si rritja e interesave libor në tregjet ndërkombëtare, pas shtrëngimit të politikës monetare nga Fed-i, ashtu dhe konkurrenca midis bankave. Në muajin gusht, interesat mesatarë të ponderuar të depozitave me afat në usd arritën në 1.06 për qind nga 0.74 për qind në muajin qershor dhe ato në euro arritën në 1.68 për qind nga 1.56 për qind.


Në përgjigje të rritjes së interesave të depozitave në valutë bankat tregtare kanë rritur edhe interesat e kredive në valutë, sidomos ato në euro, të cilat në muajin gusht arritën në 9.13 për qind nga 8.62 për qind në qershor. Ndërkohë, interesat e kredive në usd, pas rritjes në muajt qershor e korrik, në muajin gusht u ulën me 0.24 pikë përqindjeje, në 7.81 për qind.

### IV.3.3 Kursi i këmbimit

Bilanci i faktorëve të kërkesës dhe ofertës ka vazhduar të favorizojë mbiçmimin e lekut edhe gjatë tremujorit të tretë. Madje, tendencat mbiçmuese të lekut janë forcuar më shumë gjatë këtij tremujori, si pasojë e faktorëve sezonalë. Hyrjet e mëdha të valutës si pasojë e sezonit veror të turizmit dhe rritjes së fluksit të emigrantëve në këtë periudhë, kanë rritur ofertën e valutës në treg. Kjo rritje e hyrjes së valutës është reflektuar dhe në rritjen e depozitave në valutë gjatë tremujorit të tretë, afërsisht dy herë më e lartë sesa rritja e tyre në tremujorin e dytë.

Shtimi i ofertës së valutës në këtë periudhë është përballur me një kërkesë të ulët për të. Një kërkesë e tillë ka rezultuar pjesërisht si pasojë e rritjes së prodhimit bujqësor vendas dhe uljes së importit të këtyre produkteve, e pjesërisht si pasojë e diferencës së normave të interesave, e cila vazhdon të favorizojë kërkesën për mjete monetare në lekë kundrejt atyre në valutë.

**Grafik 20. Kursi i këmbimit në tregun e brendshëm valutor.**



Si pasojë e këtyre presioneve, në fund të tremujorit të tretë, usd është këmbyer me 101.2 lekë ndërsa euro me 124.8 lekë, krahasuar me respektivisht, 101.5 lekë dhe 123.1 lekë në fund të tremujorit të dytë. Në mbiçmbimin e vazhdueshëm të lekut kundrejt dollarit amerikan kanë ndikuar edhe zhvillimet në tregun ndërkombëtar të valutës, ku dollari është nënçmuar ndaj euros. Kështu, në tregun e brendshëm valutor, kursi i këmbimit lek/usd shënoi nivelet më të ulëta në tetë vitet e fundit - në 8 korrik 2004 kursi i këmbimit arriti në 100.11 lekë/usd.

Kursi i këmbimit të lekut kundrejt euros është luhatur në nivele më të qëndrueshme, mesatarisht 125 lekë/euro. Në ecurinë e tij kanë ndikuar dhe ndërhyrjet e herëpashershme të Bankës së Shqipërisë në tregun valutor<sup>20</sup>.

<sup>20</sup> Kryesisht në kahun e blerjes.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**

**Nr.68, datë 04.11.2004**

**PËR MIRATIMIN E ULJES SË PËRQINDJES SË INTERESAVE TË  
MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLTA TË RIBLERJES**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, në bazë të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë uljen me 0.25 pikë përqindjeje të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes (repo dhe repo të anasjellta). Norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes ulet nga 5.50 për qind, në 5.25 për qind.
2. Ngarkohet Departamenti i Politikës Monetare dhe i Operacioneve Monetare me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**Ylli Memisha**

**KRYETARI**

**Ardian Fullani**

### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 1, Janar 2004**

1. Vendim nr. 01, datë 28. 01. 2004 Për miratimin e “Raportit të zhvillimeve ekonomike dhe monetare për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2003”
2. Vendim nr.02, datë 28.01. 2004 Për “Miratimin e tarifave të përdorimit të sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare -AIPS”.
3. Vendim nr.03, datë 28.01.2004 Për disa ndryshime në rregulloren “Mbi funksionimin e sistemit kontabël dhe të thesarit (ATM)” miratuar me vendimin nr. 75, datë 25.09. 2002.
4. Vendim nr.04, datë 28.01.2004 Për një ndryshim në rregulloren “Mbi funksionimin e shërbimit të sistemit SËIFT” miratuar me vendimin nr. 16, datë 01.03. 2000.
5. Vendim nr.05, datë 28.01. 2004 Për miratimin e një ndryshimi në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për miratimin e rregullores “Mbi kriteret e vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve në Bankën e Shqipërisë”.

### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 2, Shkurt 2004**

1. Vendim nr. 06, datë 11.02. 2004 Për pajisjen me licencë për të ushtruar veprimtari bankare, të “Bankës Popullore” Sh.a.
2. Vendim nr. 07, datë 11.02. 2004 Për “Përcaktimin e pagës bazë të punonjësve të Bankës së Shqipërisë”.

### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 3, Shkurt 2004**

1. Vendim nr. 08, datë 25.02.2004 Për miratimin e “Raportit të Politikës Monetare për muajin janar të vitit 2004”
2. Vendim nr.09, datë 25.02.2004 Për miratimin e deklaratës të Bankës së Shqipërisë “Mbi kërcënimet e stabilitetit të sistemit financiar në Shqipëri”
3. Vendim nr.10, datë 25.02.2004 Për miratimin e rregullores “Për parandalimin e pastrimit të parave”.
4. Vendim nr.11, datë 25.02.2004 Për miratimin e udhëzimit “Mbi procedurat e nxjerrjes së urdhërzhdëmtimeve në Bankën e Shqipërisë”.

5. Vendim nr. 12, datë 25. 02. 2004 "Për miratimin e bilancit dhe për përdorimin e fitimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2003".

6. Vendim nr.13, datë 25.02.2004 Për "Pezullimin dhe ndalimin e kryerjes së disa veprimtarive të përfshira në aneksin e licencës së Bankës Italo-Shqiptare".

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 4, Mars 2004**

1. Vendim nr. 16, datë 10.03.2004 Për "Miratimin e fondit numizmatik të monedhave metalike e të kartëmonedhave shqiptare".

2. Vendim nr. 17, datë 10. 03. 2004 "Për miratimin e disa ndryshimeve në Sistemin Raportues të Unifikuar".

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 5, Mars 2004**

1. Vendim nr. 20, datë 24.03.2004 Për miratimin e rregullores "Mbi kredinë brenda ditës".

2. Vendim nr.21, datë 24.03.2004 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin "Për kapitalin rregullator të bankës" miratuar me vendimin nr. 57, date 05.05.1999 dhe ndryshuar me vendimin nr. 40, datë 16.05.2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë".

3. Vendim nr.22, datë 24.03.2004 Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren "Për mjaftueshmërinë e kapitalit".

4. Vendim nr.23, datë 24.03.2004 Për "Lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë".

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 6, Mars 2004**

1. Vendim nr. 26, datë 14. 04. 2004 Për lejimin e ushtrimit të aktivitetit kredidhënës nga Banka e Kursimeve.

2. Vendim nr. 27 datë 14. 04. 2004 "Për miratimin e transferimit të pronësisë së 100 për qind të aksioneve të kapitalit të Bankës së Kursimeve tek Raiffeisen Zentralbank".

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 7, Prill 2004**

1. Vendim nr. 28, datë 28 04. 2004 Për "Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjelltë të riblerjes".

2. Vendim nr. 29, datë 28 04. 2004 Për disa ndryshime në rregulloren "Mbi kredinë njëditore".

3. Vendim nr. 30, datë 28. 04. 2004. Për dokumentin e "Politikës Operative të Mbikëqyrjes".
4. Vendim nr. 31, datë .28 04. 2004 Për "Emërimin e Drejtorit të Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë"

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 8, Maj 2004**

1. Vendim nr. 35, datë 12 05. 2004 Për "Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të të riblerjes".

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 9, Maj 2004**

1. Vendim nr. 36, datë 26. 05. 2004 Për miratimin e Raportit "Vlerësimi i ekonomisë për tremujorin e parë të vitit 2004".
2. Vendim nr. 37, datë 26. 05. 2004 Për miratimin e transferimit të pronësisë së 100 për qind të aksioneve të kapitalit të Bankës Ndërkombëtare Tregtare tek grupi financiar ICB HOLDING AG.
3. Vendim nr. 38, datë 26. 05. 2004 Për miratimin e rregullores "Për administrimin e aktveve të qëndrueshme në Bankën e Shqipërisë".
4. Vendim nr. 39, datë 26. 05. 2004 Për miratimin e rregullores "Për nxjerrjen e vlerave materiale jashtë përdorimit".

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 10, Qershor 2004**

1. Vendim nr. 46, datë 09. 06. 2004 Për "Politikën e përdorimit të internetit dhe e-mail".

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 11, Korrik 2004**

1. Vendim nr, 47, datë 18.6.2004 Për "Miratimin e raportit të politikës monetare për muajin maj të vitit 2004".
2. Vendim nr. 48, datë 18.6.2004 "Për disa ndryshime në rregulloren për prokurimin e mallrave, të shërbimeve dhe të ndërtimeve në Bankën e Shqipërisë".

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 12, Korrik 2004**

1. Vendim nr, 50, datë 23. 06. 2004 "Disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.109, datë 24.12.2003 "Mbi kriteret e vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve në Bankën e Shqipërisë".

2. Vendim nr. 51, datë 23. 06. 2004 Për "Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjelltë të riblerjes".

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 13, Korrik 2004**

1. Vendim nr, 52, datë 14.07. 2004 Për "Administrimin e rrezikut të kredisë"
2. Vendim nr. 53, datë 14.07. 2004 Për "Shtypjen e monedhave për qëllime numizmatike, në vitin 2005".

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 14, Korrik 2004**

1. Vendim nr. 56, datë 28.07.2004 Për "Miratimin e raportit të zhvillimeve ekonomike dhe monetare për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2004".
2. Vendim nr. 57, datë 28.07.2004 Për "Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjelltë të riblerjes".
3. Vendim nr. 58, datë 28.07.2004 Për "Miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë "Mbi kërcënimin e stabilitetit të sistemit financiar në Shqipëri"". "
4. Vendim nr. 59, datë 28.07.2004 Për "Lirimin nga detyra të Drejtorit aktual dhe emërimin e Drejtorit të ri të Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë".

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 15, Gusht 2004**

1. Vendim, nr. 60, datë 18.08.2004 Për "Miratimin e raportit të politikës monetare për muajin korrik të vitit 2004".
2. Vendim nr. 61, datë 18.08.2004 Për "Miratimin e transferimit të pronësisë së 100 për qind të aksioneve të kapitalit aksioner të bankës së kursimeve sh.a. nga Raiffeisen Zentralbank Österreich AG tek Raiffeisen International Bank-Holding AG.
3. Vendim nr. 62, datë 18.08.2004 Për "Miratimin e rregullave të funksionimit të sistemit IDBS".

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 16, Shtator 2004**

1. Vendim nr. 66, datë 22.09.2004 Për "Miratimin e raportit të politikës monetare për muajin gusht të vitit 2004".